



INTERVISTA NE REPORT TV

Isuf Kalo: Kë takoi dhe çfarë tha Enveri para se të vdiste

"MOMENTI ME I VESHTIRE? SI DESH NA VDIQ NE DUAR DJALI I ENVERIT"

Ish-mjeku personal i diktatorit Hoxha ka rrëfyer në emisionin "5 pyetje nga Babaramo" disa detaje e kuriozitete nga jeta e ish-udhëheqësve komunistë. U vra apo u vetëvra Mehmet Shehu? Çfarë kujton për lidhjet e Sali Berishës me familjet bllokmenë. Roli i Nexhmije Hoxhës dhe Ramiz Alisë në vitet e fundit të jetës së Enver Hoxhës

NGA ILIR BABARAMO

► FAQE 12-14

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI IX - NR. 179 (2701) | E MARTË, 30-07-2019 | www.shqiptarja.com

GAFA E RENDE

ÇMENDET META LESHON ALARMIN, TERMET APOKALIPTIK NE SHQIPERI

Një letër e pazakontë e presidentit dërguar kryeministrit Rama, zv/kryeministrit dhe ministres së Mbrojtjes: Çfarë masa keni marrë, jam gati të mbledhë Këshillin e Sigurisë

REAGON SIZMOLOGU GREK I PERMENDUR NGA META, AKIS TSELENTI PER SHQIPTARJA.COM: QESHARAKE! NUK E KAM BERE KETE PARASHIKIM, S'KAM FOLUR KURRE ME PRESIDENTIN SHQIPTAR

► FAQE 3



Veliaj: Kush nuk paguan detyrimet e pallatit, "gjobë" tek fatura e ujit

Kryebashkiaku sqaron në Report TV risitë në administrim e pallateve. "Teatri do bëhet dhe PD do e shohë nga gardhi"

► FAQE 6

NGA VALBONA Mhilli

GARA PER KUSHTETUESEN

24 emrat që u 'dogjën' për t'u bërë pjesë e Kushtetueses

Lista e plotë e kandidatëve që u përjashtuan dhe që u tërhoqën nga gara për gjashtë vende vakante në Gjykatën Kushtetuese

► FAQE 2

NGA ADRIATIK DOçi

GRUPI I DROGES

Bleu 5 kg heroinë, si i futi në kurth agjenti 5 trafikantët

Droga futej në Shqipëri nga Maqedonia. Zbardhet dosja e plotë e prokurorisë së Durrësit

► FAQE 11

NGA ELTON QYNO

ISH-KRYEPROKURORI

Hetimi për Llallën mbërrin përgjigjia nga SHBA për shpenzimet

► FAQE 9

OPINION

Lini, fshati që për pak mund të ishte turistik

► FAQE 16

NGA EVSI CERGA

24 emrat që u 'dogjën' për t'u bërë pjesë e Kushtetueses

Lista e plotë e kandidatëve që u përjashtuan dhe që u tërhoqën nga gara për gjashtë vende vakante në Gjykatën Kushtetuese

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vijon verifikimin e kandidatëve për plotësimin e gjashtë vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti dhe Kuvendi. Javën e kaluar, KED shpalli 4 kandidatët e parë që plotësojnë kriteret për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese, ndërsa përjashtoi nga gara pesë kandidatë. Anila Guri dhe Ilir Mustafaj u përjashtuan sepse janë shkarkuar nga Komisioni i Vetingut, ndërsa Dedë Kasneci, Mimoza Qinami dhe Vladimir Gërmenji janë përjashtuar për arsye që nuk janë bërë ende me dije nga KED. Ndërkaq, Shqiptarja.com identifikon edhe një grup tjetër kandidatësh për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët janë përjashtuar nga gara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi si dhe që janë tërhequr nga gara. Ish-drejtuessa e Njësisë për Dekriminalizimin në Prokurorinë e Përgjithshme, Rovena Gashi, është përjashtuar nga gara për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Gashi kandidoi për nga gjashtë vendet vakante nga Kushtetuesja, por u shkarkua nga detyra në të dy shkallët e Vetingut, për shkak të problemeve me pasurinë. Gjithashtu, Luan Dervishi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, nuk është kualifikuar si nga KED si kandidat potencial për Gjykatën Kushtetuese. Dervishi është shkarkuar nga detyra nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, organi bazë i Vetingut. Ndërkaq, Dervishi ka kërkuar në Kolegjin e Apelimit rrëzimin e këtij vendimi dhe rikthimin në detyrë. Kolegji ende nuk ka marrë një vendim për këtë çështje. Në 14 maji të 2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka njoftuar se u ka ndaluar kandidimin për në Gjykatën Kushtetuese Denar Bibës, nënkryetar i KQZ dhe Kristaq Trajës, kryetar i KKRTSH. Po ashtu, u është ndaluar kandidimi Ardita Alsulës, Vasil Bendos dhe Kostandin Kazanxhiut. Përjashtimi i pesë emrave të fundit nuk ka lidhje me procesin e Vetingut. Gjithsej janë 12 kandidatë, të cilët kanë shprehur ambicien dhe kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e

KANDIDATËT E PËRJASHTUAR DHE TË TËRHEQUR NGA GARA PËR GJYKATËN KUSHTETUESE

Anila Guri	gjyqtare e Gjykatës së Tiranës, e shkarkuar nga Vetingu, përjashtuar nga KED.
Ilir Mustafaj	gjyqtar i Gjykatës së Tiranës, i shkarkuar nga Vetingu, përjashtuar nga KED.
Rovena Gashi	e shkarkuar nga të dy komisionet e Vetingut, përjashtuar nga KED.
Luan Dervishi	gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër, shkarkuar nga KPK, çështja në Kolegj, përjashtuar nga KED.
Dedë Kasneci	i përjashtuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
Mimoza Qinami	e përjashtuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
Vladimir Gërmenji	i përjashtuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
Denar Biba	nënkryetar i KQZ, përjashtuar nga KED.
Kristaq Traja	kryetar i KKRTSH, përjashtuar nga KED.
Ardita Alsula	përjashtuar nga KED.
Vasil Bendo	përjashtuar nga KED.
Kostandin Kazanxhi	përjashtuar nga KED.

KANDIDATËT E TËRHEQUR NGA GARA

Ardian Dvorani	është tërhequr nga kandidimi për shkak, për shkak se është kryetar i KED, konfirmuar në detyrë nga Vetingu
Medi Bici	është tërhequr nga kandidimi për shkak se u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, konfirmuar në detyrë nga Vetingu
Çlirim Gjata	i tërhequr nga gara, për shkak se mban post politik në Partinë Demokratike.
Elsa Toska	këshilltare ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese, e konfirmuar në detyrë nga Vetingu, por është tërhequr nga gara
Alban Brati	i tërhequr nga gara.
Irena Reso	e tërhequr nga gara.
Theodhori Sollaku	i ish-kryeprokuror, tërhequr nga gara.
Avni Shehu	ish-kryetar i Gjykatës së Kasacionit, i tërhequr nga gara.
Genci Ismaili	i tërhequr nga gara.
Elira Kokona	tërhequr nga kandidimi.
Kestrin Katro	tërhequr nga kandidimi.
Prel Martini	tërhequr nga kandidimi.

KANDIDATËT E KUALIFIKUAR PËR 6 VENDE VAKANTE NË KUSHTETUESE

Arta Vorpsi	për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
	për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
	për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
	për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
Besnik Muçi	për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
	për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 12.02.2018;
	për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
Fiona Papajorgji	për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 04.03.2019;
	për vendin vakant të shpallur nga Kuvendi, në datën 04.03.2019;
Regleta Panajoti	për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018;
	për vendin vakant, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018.



Përjashtimi

Janë 12 kandidatë, të cilët kanë shprehur ambicien dhe kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e drejtësisë, por që janë përjashtuar nga gara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.



Tërheqjet

12 kandidatë kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese, por që më pas janë tërhequr nga gara. Pjesë e kësaj liste edhe Çlirim Gjata, aktualisht Sekretar për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike.



drejtësisë, por që janë përjashtuar nga gara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

TËRHEQJET

12 kandidatë kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese, por që më pas janë tërhequr nga gara. Pjesë e kësaj liste edhe Çlirim Gjata, aktualisht Sekretar për Çështjet Ligjore në Partinë Demokratike. Në një kohë kur Lulzim Basha dhe Sali Berisha akuzonin Edi Ramën për kapjen e drejtësisë, sekretari i partisë së tyre Çlirim Gjata ishte në garë për t'u bërë pjesë e gjykatës më të rëndësishme në Shqipëri. Gjata ka marrë postin Sekretarit në PD në janar të këtij viti, ndërsa letra e tij e dorëheqjes nga gara mban datën 10 prill 2019, kohë gjatë së cilës KED ka thirrur Gjatën për t'u paraqitur, me qëllim për të nisur verifikimin dhe vlerësimin e tij si kandidat për

në Gjykatën Kushtetuese. Pra, dorëheqja e tij ka ardhur në momentin që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka nisur procedurat për ta verifikuar, ku përfshihet edhe kontrolli i pasurisë.

ARDIAN DVORANI DHE MEDI BICI

Anëtar i vetëm i Gjykatës së Lartë, Ardian Dvorani, është tërhequr nga kandidimi për një vend në Gjykatën Kushtetuese, për shkak se është kryetar i KED. Gjithashtu nga gara është tërhequr edhe Medi Bici, për shkak se u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Që të dy janë konfirmuar në detyrë me vendime të formës së prerë. Ish-kryeprokurori Theodhori Sollaku dhe ish-kryetar i Gjykatës së Kasacionit Avni Shehu, kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Që të dy u tërhoqën nga kandidimi.



NALLBATI / 'KRYEBASHKIAKU I VETËSHPALLURI PS ËSHTË NGUJUAR NË ZYRË'

Kreu i ri i Devollit në zyrë në 06:30, PD-ja 9 orë protestë

Kryetari i ri i Bashkisë së Devollit Eduard Duro ka shkuar në zyrë dje që në orën 06:30. Frika se mos ish-kryetari do të shkonte më herët për t'i zënë zyrën ka bërë që Duro të shkonte 90 minuta përpara. Ndërkohë që para bashkisë kanë filluar që të grumbullohen edhe mbështetësit e opozitës prej orës 07:30. Në ambientet e bashkisë ndodheshin rreth 30 forca policie të drejtorisë vendore, por edhe FNSH-së. Efektivët ishin të pranishëm në ambientet e jashtë institucionit për të shmangur incidentet. Duro u betua ditën e premte në mesditë, ndërsa në zyrë shkoi pasdite kur u largua ish-kryetari. Protesta e mbështetësve të djathtë para Bashkisë së Devollit ka zgjatur 9 orë. Në fjalën e tij, kryebashkiaku në ikje Bledjon



Nallbati ka deklaruar se aksioni opozitar do të vazhdojë. "Protesta sot tregoi qartë vullnetin e devollinjeve për të mos pranuar farsën e 30 qershorit, cili na ka sjellë në këtë situatë duke vazhduar me urzupimin e institucioneve në mënyrë të dhunshme, jashtë orarit. Kryetari i vetëshpallur i 30 qershorit është ngjuar në zyrë të vet vetëm me njerëzit e tij duke mos mundur të organizojë dhe të zhvillojë asnjë shërbim. Do ta vazhdojmë aksionin tonë, për ligjshmëri dhe zgjedhje të lira dhe të ndershme", u shpreh ai. Në shenjë simbolike, pas akuzave të kryebashkiakut në ike, Bledjon Nallbati se kryebashkiaku i ri i dalë nga 30 qershori është ngjuar në zyrë, protestuesit i kanë dorëzuar një dyshek. Më herët, nënkryetari i PD-së, Edi Paloka ka bërë të hënën

thirrje për dhunë ndaj policisë. Ai ka postuar një foto në faqen e tij në Facebook nga ajo që ndodhi sot në Devoll ndërsa shkruan se policia po mbron hajdutin dhe se qytetarët e Devollit duhet të sillen ndaj tyre, njëloj siç sillen me një grabitës. "I shihni këta me uniforme ku shkruan "Policia"? Janë në Bashkinë e Devollit! Po nuk janë aty për të kapur hajdutin e Ramës që ka hyre duke thyer derën, natën, kur të zotët e shtëpisë nuk ishin aty. Këta edhe pse mbajnë uniformë, janë pjesë e bandës. Janë aty për të mbrojtur hajdutin me urdhër të kryehajdutit. Grabisin prona publike, grabisin prona private dhe as nuk fshihen më! Grabisin me dhunë! Silluni me ta siç do silleshit me një grabitës që ju ka hyrë në shtëpi po pa njoftuar "policinë që nuk duam", shkruan ai.

Letra e plotë e Presidentit Meta



"Të nderuar
Nëpërmjet medias ndërkombëtare dhe kombëtare jam informuar mbi paralajmërimin për një tërmet apokaliptik që pritet të godasë Ballkanin. Paralajmërimi ka ardhur nga sizmiologu i njohur, z. Akis Tselentis, drejtor i Institutit Gjeodinamik Observatori Kombëtar i Athinës.

Sizmiologu Tselentis ka paralajmëruar për një tërmet apokaliptik që pritet të godasë Ballkanin, që mund të jetë 30 herë më i fuqishëm se ai që goditi para disa ditësh rajonin e Athinës.

Për shkak të karakteristikave të veta sizmike vendi ynë është një nga vendet me sizmicitetin më të lartë në Evropë. Prandaj Shqipëria është një vend i kërcënuar nga kjo dukuri natyrore.

Për sa më sipër, kërkoj nga ana juaj të informohem mbi: Institucionet përgjegjëse, a kanë kontaktuar me sizmiologun Tselentis dhe institucionet homologe. të rajonit lidhur me të dhënat e tyre për paralajmërimet të tilla?

Cilat janë kapacitetet tona për përballimin dhe masat e marra nga ana juaj, nëse vendi ynë do të goditet nga një tërmet i përmasave të tilla.

Çfarë masash janë marrë apo do të merren për të reaguar në kohë dhe për të minimizuar pasojat e mundshme në nivel qëndron dhe vendor?

Nëse e gjykoni të domosdoshme, jam i gatshëm të mbledh Këshillin e Sigurisë Kombëtare menjëherë qoftë dhe vetëm për këtë çështje, pasi çdo nënvlerësim i situatës mund të jetë me pasoja tragjike për jetën e qytetarëve në radhë të parë.

Presidenti i Republikës, Ilir Meta".

Basha:

Bashkia e Devollit u uzurpua nga regjimi, hajdutët i pret burgu

Kryetari i PD-së, Lulzim Basha ka reaguar për situatën e krijuar në bashkinë e Devollit ditën e sotme. Ai shprehet se pushteti i paligjshëm po uzurpon qeverisjen lokale, ndërsa ka edhe një paralajmërim. "Pushteti i paligjshëm i 6% po uzurpon me dhunë qeverisjen lokale, kundër vullnetit të popullit. Ky regjim kriminal dhe plaçkitës po hyn në rrugën e verbër të përplasjes me popullin e tij. Sot hajdutët në pushtet ndjehen të mbrojtur se kanë polici speciale, gaz lotsjellës dhe mercenarë, por nesër do të kenë fatin që meritojnë hajdutët dhe banditët", shkruan Basha. Ndërsa ish-deputeti demokrat Ervin Salianji deklaroi se opozita nuk do të tërhiqet nga bashkia e Devollit. "Qytetarët nuk do të tërhiqen. Do të jemi në mbështetje për shkak të kërcënimeve që bëhen ndaj administratës. Këtu ka qenë një njeri (i referohet Eduard Duros) që ka fjetur nga dita e premte dhe deri sot", tha ai.

Gafa e rëndë

Meta citon gabim sizmiologun grek, ngre alarm për tërmet

Sizmiologu grek Akis Tselenti përgënjeshtroi Presidentin Meta: Fake news...qesharake!

Një letër e pazakontë e presidentit Ilir Meta i është dërguar kryeministrit Edi Rama, zëvendëskryeministrit Erjon Braçe dhe ministres së Mbrojtjes Olta Xhaçka, ku kreu i shtetit flet se vendi ynë duhet të përgatitet për përballjen me një tërmet apokaliptik që mund të godasë Ballkanin. Kreu i shtetit shfaqet mjaft i shqetësuar në lidhje me një parashikim të një sizmiologu të vjetër grek. Por teksa Presidenti citon në letrën e tij drejtorin e Institutit Gjeodinamik Observatori Kombëtar të Athinës, Akis Tselentis, konkretisht për "një tërmet apokaliptik që pritet të godasë Ballkanin, që mund të jetë 30 herë më i fuqishëm se ai që goditi para disa ditësh rajonin e Athinës", siç Meta shkruan në letër, e vërteta është tjetër. Shqiptarja.com kontaktoi përmes e-mailit me sizmiologun e vjetër grek, i cili në përgjigjen e tij përgënjeshtroi Presidentin Meta duke thënë se nuk ka biseduar kurrë me të dhe se asnjëherë nuk ka bërë një parashikim të tillë. "Asnjëherë nuk kam bërë asnjëherë asnjë parashikim specifik për tërmete. E gjitha kjo është fake (e rremë) dhe qesharake. Asnjëherë nuk kam qenë në kontakt me presidentin tuaj", përgjigjet ekskluzivisht për Shqiptarja.com sizmiologu Akis Tselentis.

CITIMI I GABUAR

Mbi citimin e gabuar, që nuk ekziston, Presidenti Ilir Meta, vishet me "kostumin" e sizmiologut, kur thotë se "vendi ynë



është një nga vendet me sizmicitet më të lartë në Evropë, prandaj Shqipëria është një vend i kërcënuar nga kjo dukuri natyrore", - thuhet në letër. Kreu i shtetit, kërkon nga qeveria të informohet mbi situatën, dhe a ka kapacitete vendi ynë për të përballuar një tërmet të përmasave të tilla? Meta shkon deri aty sa thotë se është gati të mbledhë Këshillin e Sigurisë Kombëtare. "Kërkoj nga ana juaj të informohem mbi: Institucionet përgjegjëse, a kanë kontaktuar me sizmiologun Tselentis dhe institucionet homologe. të rajonit lidhur me të dhënat e tyre për paralajmërimet të tilla? Cilat janë kapacitetet tona për përballimin dhe masat e marra nga ana juaj, nëse vendi ynë do të goditet nga një tërmet i përmasave të

tilla. Çfarë masash janë marrë apo do të merren për të reaguar në kohë dhe për të minimizuar pasojat e mundshme në nivel qëndron dhe vendor? Nëse e gjykoni të domosdoshme, jam i gatshëm të mbledh Këshillin e Sigurisë Kombëtare menjëherë qoftë dhe vetëm për këtë çështje, pasi çdo nënvlerësim i situatës mund të jetë me pasoja tragjike për jetën e qytetarëve në radhë të parë", - shkruan Meta në letrën drejtuar Ramës, Braçes dhe Xhaçkës.

LETRA

Shqiptarja.com mësoi nga burime pranë Presidencës se letra është e vërtetë, ndërsa nga kryeministria u konfirmua se letra ka mbërritur pranë institucionit të tyre. Edhe nga një kërkim i thjeshtë që Shqiptarja.com bëri në mediat ndërkombëtare, nuk flitet për asnjë deklaratë të tillë. Shkrimi i fundit është ai i 22 korrikut 2019, ku sizmiologu grek thotë: "Të gjithë thanë se Athina rezistoi. Ajo nuk rezistoi. Imagjonin nëse do të kishte pasur një tërmet që mund të ishte i shkallës 6 Rihter, me fjalë të tjera, me magnitudë 30 herë më të fuqishme", është citimi i saktë i Akis Tselentis, që citojnë mediat e huaja.

Nga një vështrim në internet, shihet se sa herë Greqia është prekur nga tërmetet, sizmiologu i njohur Tselentis, paralajmëron lëkundje të tjera tërmetesh. Por asnjëherë ai nuk është shprehur për një të tillë, 30 herë më të fuqishëm, një tërmet apokaliptik që mund të rrezikonte Ballkanin.

Teatër i ri? Soreca: Ne kërkojmë tender me standarde!

Ambasadori i BE-së: Nuk themi nëse duhet të ketë një ndërtesë të re ose jo, qeveria të jenë transparente edhe pa qasje diskriminuuese në treg


Ambasadori i BE-së në vendin tonë Luigi Soreca komentoi debatin e fundit që ka përfshirë politikën për teatrin Kombëtar. Ai tha se nuk është BE-ja ajo që duhet të thotë nëse duhet të ketë një ndërtesë të re ose jo, pasi këtë e kanë përgjegjësi autoritetet shqiptare, por kishte vetëm një kërkesë, respektimin e standardeve evropiane për tenderin dhe konkurrencën e lirë. “Dëshiroj të them se kjo është çështje shumë e rëndësishme edhe është pjesë e një debati intensiv që po bëhet në shoqërinë shqiptare ku janë përfshirë shumë ndjesi edhe interesa. Për këtë arsye është një çështje delikate edhe e politizuar. Nuk duhet të jemi ne ata që themi nëse duhet të ketë një ndërtesë të re ose jo, këtë e kanë përgjegjësi autoritetet shqiptare. Ashtu sikur e dini edhe ju pozicioni ynë ka qenë i qartë që nga shtatori i vitit të shkuar, BE i ka bërë thirrje qeverisë që të jenë transparente edhe pa qasje diskriminuuese në treg. Ky duhet të jetë parimi që duhet të udhëheqë autoritetet shqiptare, prandaj është lancuar edhe tenderi për më tej. Mendoj se është shumë e rëndësishme që të ketë kritere të qarta edhe transparente, edhe të ketë një qasje të drejtë për këtë çështje. Ajo që është e rëndësishme për ne është sundimi i ligjit, procedurat e tenderit duhet të jenë në përputhje me ato të BE-së, mesa di tenderi është i hapur deri në 19 shtator. E rëndësishme është edhe konkurrenca e lirë dhe e drejtë. Elementi më i rëndësishëm për ne është konkurrenca e lirë”, tha ai. I pyetur mbi deklaratën e sekretarit të OSBE-së, Thomas Greminger, Soreca tha se “Kjo është një çështje që vazhdon që të ketë debat të madh në Shqipëri. Për ne është e rëndësishme shteti i së drejtës. Tenderi është i hapur deri në muajin shtator. Janë institucionet shqiptare që duhet të marrin vendimin për këtë çështje. Brenda periudhës së tenderimit të sigurohet një konkurrencë e drejtë sipas rregullave. Për ne është e rëndësishme liria e shprehjes së artistëve që ajo të ruhet edhe këtë po bëj. Në mbështetjen e shprehjes së artistëve edhe do të diskutojmë me ta në vijim”, tha ai. Regjisori Robert Budina, pjesë e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit i pranishëm në aktivitetin për “Za Fest” replikoi duke thënë se nuk është dakord me



Soreca
“Nuk duhet të jemi ne ata që themi nëse duhet të ketë një ndërtesë të re ose jo, këtë e kanë përgjegjësi autoritetet shqiptare. BE i ka bërë thirrje qeverisë që të jenë transparente edhe pa qasje diskriminuuese në treg”.



Budina “Nuk jam dakord me ju. Qeveria para se të nisë tenderin duhet të presë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se kemi gjysmën e popullit të papërfaqësuar. Vazhdoni mbështetjen për artin shqiptar, se është e vetmja mënyrë që Shqipëria të futet në BE”.



Qendrimi

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit si parti politike, sulmon Sorecën

Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit ka marrë qëndrimin e një partie politike opozitare përmes deklaratave të saj tërësisht politike. Në një përgjigje lidhur me deklaratën e bërë nga ambasadori i BE në Shqipëri Luigi Soreca, aleanca akuzon këtë të fundit se po rreshtohet në krah të Ramës. Ajo e quan deklaratën e Sorecës, të pajustifikuar, të panevojshme dhe të dëmshme. Ambasadori i BE në Shqipëri Luigi Soreca i është përgjigjur Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit e cila e quajti deklaratën e tij të pajustifikuar, të panevojshme dhe të dëmshme. Soreca thotë se deklarata e tij është paraqitur jashtë kontekstit duke risjellë edhe njëherë deklaratën ku është shprehur se lidhur me ndërtimin e teatrit kombëtar duhet siguruar një transparencë e procedurave dhe konkurrencë e drejtë dhe e lirë.

ambasadorin. “Nuk jam dakord me ju. Qeveria para se të nisë tenderin duhet të presë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, se kemi gjysmën e popullit të papërfaqësuar. Vazhdoni mbështetjen për artin shqiptar,

se është e vetmja mënyrë që Shqipëria të futet në BE”, tha ai.

DEKLARATAT

Deklaratat ambasadori i bëri gjatë aktivitetit për edicionin e tretë të “Za Fest” në natyrën

Komenti

Analisti krah PD-së: Soreca, një ambasadoruc që spërdridhet

Ndonëse ndërkombëtarët janë shprehur se çështjet e rëndësishme në vend i përkasin autoriteteve shqiptare, opozita nuk i ndal sulmet ndaj tyre. Pas sulmeve që PD dhe LSI lidhur me datën e zgjedhjeve, ambasadorët janë sulmuar nga Aleanca për Teatrin dhe PD edhe për qëndrimin që ata po mbajnë për çështjen e Teatrit Kombëtar. Pedagogu dhe aktivisti, Ergys Mërtiri një ndër personazhet i parë krah PD-së për çështjen e Teatrit Kombëtar, ka reaguar pas deklaratave të sotme të ambasadorit të BE-së në Tiranë, Luigi Soreca i cili tha se kjo është një çështje e vetë autoriteteve shqiptare. Mërtiri ka sulmuar ambasadorin e BE Soreca duke e quajtur atë ambasadoruc që spërdridhet për të dalë në mbrojtje të kryeministrit Rama. “Një ambasadoruc si Soreca, mundohet të spërdridhet pas fjalëve për të dhënë një përgjigje as mish e as peshk për këtë çështje”, shkruan Mërtiri.

e mahnitshme të Thëthit më 2, 3 dhe 4 gusht. Delegacioni i BE-së në Shqipëri shprehet krenar që do të mbështesë edhe këtë vit “Za Fest”, ndërsa ambasadori tha se ky festival është pikërisht mesazhi që dëshiron

të përçojë BE-ja në Shqipëri. “Jam vërtetë shumë i kënaqur që jam këtu përpara jush me Vlashentin për të prezantuar Za Fest-in. Diskutimet i kemi filluar më parë, ky ZA Fest do të jetë i mrekullueshëm. Në

fakt kur erdhi Vlashenti dhe diskutoi me mua, e kuptova menjëherë sa i rëndësishëm do të ishte në lidhje me qasjen e BE-së në Shqipëri. Mesazhi i ZA Fest-it është pikërisht mesazhi që dëshiron të përçojë BE-ja në Shqipëri, pasi është në përputhje me politikat e BE-së, kulturën, artin dhe zhvillimin e turistit. Ideja është që të bashkojmë njerëzit me kulturën dhe artin, dhe këtë ta bëjmë edhe në veri, qasja e BE vjen këtu me tre fjalë: Rigjallërim, zhvillim dhe ruajtje e kulturës. Rigjallërimi, e them se me anën e këtij festivali do të rigjallërojmë këto vlera dhe tradita të rëndësishme shqiptare, do të na vijnë përmes përrallave që do të tregojnë artistët ato ditë atje. Pika e dytë ka të bëjë me zhvillimin e zonave malore të Shqipërisë, t'i ndihmojmë të arrijnë potencialin e tyre. Kjo iniciativë është shumë e rëndësishme. Ne dëshirojmë të shkojmë përtej kufijve, kemi një projekt ndërkufitar me Kosovën, që këto çështje t'i çojmë jo vetëm në Kosovë, por edhe vendet e tjera”, përfundoi ai.

Kritiku i artit, Papagjoni: Duhet një teatër i ri, rikonstruksioni nuk ia vlen

Kritiku i artit, Josif Papagjoni shprehet pro ndërtimit të një godine të re të Teatrit të Kombëtar e cila do të shërbejë sipas tij edhe si një pikë orientimi urbane e qendrës së qytetit. “Aty ka ardhur koha që të ndërtohet një godinë e re teatrore, pra një teatër kombëtar i Shqipërisë, që supozohet që është nga institucionet bazë, vitale, të njëmendëta dhe që njëkohësisht mund të shërbejë pse jo edhe si një pikë orientimi urbane e qendrës, dhe vetë tërësisë së Tiranës”, deklaroi ai. Studiues e kritik i teatrit, kinematografisë e letërsisë, profesor Papagjoni thotë se nevoja për një godinë të re të Teatrit Kombëtar është e hershme. Papagjoni shprehet



se rikonstruksioni i asaj godine është shumë i vështirë dhe se një godinë teatri do të kërkonte kushte shumë të ndryshme nga ai që ofron teatri sot. “Mendoj se ai teatër sot është në gjendje të mjeruar. Gjykoj se është shumë e vështirë të bësh një rikonstruksion atje, që ta vësh në funksion të produktit teatror që prodhohet në atë godinë. Sepse një godinë teatrore me parametrat e duhura të saj, do kërkonte kushte me të ndryshme nga çka ai teatër sot. Unë anoj nga ideja që aty të bëhet një Teatër i ri Kombëtar me gjithë parametrat e një godine futuriste, të bukur, sikundër e pamë, për fatin tonë të mirë do të thosha nga një arkitekt me

shumë zë në arkitekturën botërore. Dhe ai po sjell një projekt shumë të bukur”, tha Papagjoni, ndërsa shton se kjo godinë nuk ka vlera arkitekturore. “Në radhë të parë ajo është godinë e ndërtuar nga italianët, por është përvetësuar nga ne. Por a është vlerë arkitekturore? Zhvillimi i shoqërisë është i tillë, avancimi teknologjik, dinamika është e tillë. Ne nuk mund të qëndrojmë pjesë e një mendësie përdhës, otoman, ne nuk jemi këtu, por ne nuk mund të themi se ajo është si godinat e tjera, ministritë, Akademia e Arteve, kanë ndërtimin e tillë, kanë gurë. Ndërsa ajo është me dërrasa, me tallash”, thekson studiuesi i njohur.



Edi Rama sjell zërin e regjisorit: Shumica do teatër tjetër!

Lulzim Basha: Ai që nuk distancohet është bërë pis. Vasili: Shembja e Teatrit skandal i dimensioneve kombëtare

Kryeministri Edi Rama vijon që të sjellë zërat e artistëve të njohur që janë pro ndërtimit të një teatri të ri kombëtar mbi rrënojat e të vjetrit, projekt të cilin e kundërshton një grup artistësh të mbështetur nga Partia Demokratike. Përmes një postimi në Facebook Rama risjell deklaratën e regjisorit Altin Basha, që pak kohë më parë shprehej se godina aktuale nuk ofron




mundësinë për zhvillimin e një krijimtarie cilësore teatrore. “Regjisor Altin Basha, një ndër emrat më të spikatur të gjeneratës së re të krijuesve të skenës, mbështet njësoj si shumica dërrmuese e komunitetit teatror shqiptar, ndërtimin e Teatrit të Ri Kombëtar dhe shembjen e gjermadhës ekzistuese. Altin Basha: Qartë dhe shqip, unë mendoj se duhet një godinë e re. Pjesa muzeale mund të zgjidhet brenda godinës së re. Si regjisor, po ju deklaroj me përgjegjësi, se ajo godinë nuk ofron mundësinë për zhvillimin e një krijimtarie cilësore teatrore dhe, për rrjedhim, një cilësi të ulët produkti për spektatorët dhe qytetarët”. Kryetari i PD-së Lulzim Basha ka reaguar për Teatrin Kombëtar duke deklaruar se ai që nuk distancohet tregon se është bërë pis. “Hajduti psikik Rama vazhdon të përdorë e keqpërdorë këdo që i del para për të mbrojtur aferën Rama-Veliaj-Mafia të 6 kullave 200 milionë euro. Pa kullat nuk ka asnjë interes për teatër të ri. Afera Rama-Veliaj-Mafia po bën pis dhe hedh dyshime korrupsioni financiar mbi këdo që përdoret dhe nuk distancohet nga kjo aferë e tmerrshme kriminale dhe hajdutërore. Sepse gjoja debati për Teatrin Kombëtar është në fakt për 6 kullat e për të futur në xhep 200 mln euro, dhe jo për Teatrin. Sepse për Rama-Veliaj-Mafian e Ndërtimit dhe të Drogës nuk ka Teatër pa kulla. Për këdo të pafunduar apo të keqinformuar po postoj më poshtë përshkrimin grafik të planit Rama-Veliaj-Mafia e Ndërtimit dhe Drogës për 6 kullat 200 milionë euro, arsyeja e vetme për prishjen e Teatrit Kombëtar”, tha ai.

VASILI: SKANDAL I DIMENSIONEVE KOMBËTARE

Protestat për të luftuar qeverinë Rama kanë kaluar në plan të dytë dhe opozita ka përqafuar kauzën për mbrojtjen e teatrit. I gjithë aksioni opozitar është fokusuar në mbrojtjen e Teatrit, atë që ata e quajnë si :beteja e ligjit kundër antiligjit”. Nga selia e LSI, ish-deputeti Petrit Vasili

Genc Fuga:
Dua një teatër të ri, të mos vidhet hapësira e teatrit




Aktori Genc Fuga ka një qëndrim të ndërmjetëm për çështjen e Teatrit Kombëtar. Fugo është pro një teatri të ri, por kundër cënimit të hapësirës së teatrit, pra kundër kullave. “Dua që të kem një Teatër Kombëtar LUKSOZ!!! Një Teatër që të të imponohet jo vetëm në mënyrën e sjelljes e të veshjes, por edhe në mënyrën e të menduarit. Dua që të ruhet e nderohet gjithë historia e Artit Skenik Shqiptar! Mos kujtoni se do të kemi në “Muze” histori qindvjeçare! JO! Jemi në kohën e duhur për të dhënë atributet e merituar Korifejve të Skenës Shqiptare! Godina aktuale e painvestuar është në kushte skandaloze skenike. Petrit Vasilin (në cilësinë e mjekut dhe bashkëpunëtorit shkencor) e kam ndjekur në një kronike televizive duke publikuar një libër për efektet kancerogjene të eternitit. Këtë promovim të punës së tij shkencore, për “ilustrim”, ai po e bënte pikërisht në hollin e kësaj godine...” shkruan Fuga.

ka dalë në një konferencë për mediat, ku ka argumentuar se përse kjo “betejë” është e rëndësishme, e ndërsa iu është përgjigjur edhe akuzave se kjo protestë tashmë nuk është më vetëm qytetare, por e politizuar. “Ky skandal i dimensioneve kombëtare është aty në mes të sheshit. Një skandal i tillë s’do guxohej të ndodhte në asnjë kryeqytet evropian të perëndimit, ku aktorë e protestues janë dhunuar mes sheshit, janë rrethuar duke mos u lejuar as ujë të pinë, dhe gjithë kjo dhunë shtazarakë ka qenë vetëm në funksion të grabitjes së pronës publike, dhunimit të interesit publik dhe vijimësi e planit të zi për instalimin e antishtetit. Përfundimisht, Teatri është vijë ndarëse edhe për ndërkombëtarët që janë shndërruar në avokate të qeverisë dhe që dëgjojnë vetëm italishten e qeverisë ndërkohë që edhe në opozite ka mjaft që e flasin italishten, por atë të së vërtetës dhe jo atë të korrupsionit dhe grabitjes”.

FAKTET: Si e tjetërsuan Berisha e Basha Kinostudion

Kreu i opozitës Lulzim Basha ka nënshkruar marrëveshje me një grup artistësh për të mos lejuar shembjen e godinës ekzistuese të Teatrit Kombëtar, që i hap rrugë ndërtimit të teatrit të ri, i cili është miratuar me ligj që një vit më parë. Por pyetja që lind sot është se ku ishte Lulzim Basha dhe gjithë ata që mbrojnë teatrin dhjetë vite më parë, kur artistëve iu morën arbitrarisht ambientet e Kinostudios, të cilat iu dhanë në përdorim televizioneve private?! Realstory ka bërë një verifikim si për figurat politike, ashtu edhe për artistët që sot kundërshtojnë teatrin e ri se çfarë qëndrimi kanë mbajtur ata në kohën tjetërsimit të Kinostudios. Për të rikthyer në kujtesë, dhjetë vite më parë, pikërisht në shkurt të vitit 2009, qeveria e drejtuar nga kryeministri Sali Berisha mori një vendim për t’u dhënë në përdorim ambientet e Kinostudios, rreth 80 mijë metra katrorë, disa televizioneve private, ku fillimisht krijoi një konflikt me ish pronarët, të cilët kishin fituar të drejtën e pronës në Gjykatën e Lartë dhe më pas pati një konflikt të ashpër me Akademinë Marubi, e cila ishte vendosur në ambientet e Kinostudios prej disa viteve. Kreu i opozitës, Basha në atë kohë ishte pjesë e këtij vendimi, pasi në kabinetin Berisha mbante postin e Ministrit të Jashtëm, ndërsa sot luan “teatër”, duke iu premtuar aktorëve se nuk do të shembet godina, por do të restaurohet. Ndoshta ashtu siç ndodhi edhe me Kinostudion?! Në atë kohë, asnjë prej qeverisë apo Partisë Demokratike, nuk doli në mbrojtje të ambienteve të ish-Kinostudios, kështu që ndoshta sot më mirë sesa Basha u premtonte aktorëve restaurim teatri, duhet t’u kërkojë falje për “mëkatet” e qeverisë, ku ishte pjesë



edhe vetë. Por, jo vetëm Basha. Pas këtij vendimi të qeverisë Berisha në vitin 2009, asnjë prej artistëve, që sot janë kundër shembjes së godinës ekzistuese të Teatrit Kombëtar nuk dolën kundër vendimit. Nuk pati asnjë protestë dhe tubim. Veç përplasjeve të disa drejtuesve dhe studentëve të Akademisë Marubi nuk pati asnjë kundërshtim tjetër. Edhe më i tharë që sot janë kundër shembjes së teatrit, 10 vite më herët nuk thanë asnjë fjalë. Nga verifikimi rezulton se vetëm Edmond Budina ka qenë një nga artistët që disa vite më vonë e ka dënuar atë që i ndodhi Kinostudios. “Atë pasuri e shkatërruan, dhe për mua është një nga krimet më të mëdha të kulturës shqiptare. Hynë hajdutët me çizme dhe e shkatërruan Kinostudion, sepse nuk gjej dot një arsye tjetër kur e shikoj sot të copëtuar dhe të privatizuar në atë mënyrë”, shprehej ai në një intervistë

disa vite më vonë. Ndërsa artistët e tjerë, të cilët janë kundër projektit të teatrit të ri, si regjisor Robert Budina, aktorët Neritan Liçaj, Julian Deda, Romir Zalla, Gent Zeneli, Mehdi Malkaj, Sesilia Plasari rezultojnë se asnjë prej tyre nuk kanë thënë ndonjë fjalë për privatizimin e Kinostudios. Kurse Robert Ndrenika si për Kinostudion ashtu dhe për Teatrin është shprehur se është pro modernizimit të ambienteve, pavarësisht akuzave të kolegëve. Madje një qëndrim për modernizimin e Kinostudios, Ndrenika ka mbajtur që në vitet ’90, kur ishte deputet. Ndoshta edhe aktorët, ashtu si Basha duhet të bëjnë një “Mea culpa” për Kinostudion, e cila jo vetëm që nuk u modernizua, por u tjetërsua, para se të mos lejojnë ndërtimin e Teatrit të Ri Kombëtar me shpresën se opozita, që dje fali ambientet e Kinostudios, nesër mund t’u rregullojë teatrin. /Realstory/

Veliaj: Kush s'pagueu detyrimet e pallatit, "gjobë" tek fatura e ujit

Kryebashkiaku Erion Veliaj sqaron në Report TV risitë në administrim e pallateve. "Teatri do bëhet dhe Partia Demokratike do e shohë nga gardhi"

VALBONA Mhilli
TIRANE

Një nga risitë që bashkia e Tiranës vuri në jetë, ishin administratorët e pallateve. Kryetari i bashkisë së Tiranës Erion Veliaj i ftuar dje në Report TV në emisionin "Këndi i Ekspertit" tha se vendosja e njerëzve që kanë përgjegjësi në këtë detyrë, ka sjellë ndryshime pozitive në të jetuarit në komunitet. Sa i përket pagesave që banorët e pallatit duhet të bëjnë për ndriçimin dhe pastrimin, Veliaj tha se më korrektët janë pensionistët ndërsa ata me lekë shumë - shtoi ai, nuk paguajnë. Në këto raste do të ndërhyhet duke e vendosur vlerën e pastrimit dhe ndriçimit tek fatura e ujit. Por qytetari i parë i Tiranës, nuk përjashtoi edhe mundësin e gjobave administrative siç funksionon në vende të ndryshme të botës ndaj banorëve që nuk kontribuojnë për bashkëjetesën në komunitet. "Nuk paguajnë ata që nuk kanë mundësi ekonomike, ata që janë pensionistë dhe invalidë janë më korrektët. Ata që kanë më shumë kontribuojë më pak, se mendojnë se nuk kanë detyrime. Në taksën e bashkisë, pastrim ujë drita, ata tangërlleksin që duan dy vende parkimi janë edhe më jo bashkëpunuesit. Nëse dikush është me ndihmë ekonomike ne i nxjerrim nga skema e pagesës së pallatit. Njerëzit më nevojtarë janë në pallate të vjetra me më pak banorë që edhe tarifa është më e vogël. Ajo minorancë e vogël, do ja fusim tek fatura e ujit, dhe aty bëjmë edhe diferencën se kush është me ndihmë ekonomike e kush jo. Edhe të pasurit duhet të mësojnë nga ata më modestë. Nëse nuk paguajnë do të ketë një fazë kohe, 2-3 muaj kohë për të bërë pagesën dhe do të vijë tek fatura e ujit, ose do të të vijë një gjobë administrative, ke ardhur në tiranë duhet të pranosh ligjësinë që e bëjnë të funksionojë si bashki", tha kryetari i Bashkisë së Tiranës tek "Këndi i Ekspertit".

DEBATI PËR TEATRIN E RI

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, thotë me bindje se Teatri i Ri Kom-bëtar do të ndërtohet, dhe se protesta që një grup artistësh po bëjnë kundër tij, është e gjitha politike. Veliaj tha se në protestë janë artistë që nuk kanë shkelur në skenën e teatrit prej viteve '91-'92. Ndërsa lidhur me paktin mes PD-së dhe artistëve, ai tha se



firma duhej të ishte vënë në selinë blu, pasi kryetari Lulzim Basha lidhi marrëveshje me anëtarët e tij të Këshillit Kom-bëtar të PD-së që i ka nxjerrë në protestë kundër projektit të radhës të bashkisë.

"Teatri do të bëhet dhe ata do ta shohin nga gardhi. Tani, të politizosh çdo gjë, përkundrazi e redukton opozitën nga një shtëpi e madhe në një kotec. Sot ne jemi në një situatë ku PD ka selinë më të madhe sot në Shqipëri të një partie. S'ka asnjë deputet, asnjë kryetar bashkie, asnjë anëtar të Këshillit Bashkiak. Për sa kohë që ti nuk ke asnjë kontribut publik zyrtarisht, formalisht, ligjrisht për çfarë e mban këtë? Ajo mbahet me

taksa, është pronë publike. Jepja teatrit! Sot Lulzim Basha ka mundësi ta mbajë fjalën tani, jo nesër se shqiptarët e hëngrën njëherë, me votoni se do bëj trametin dhe nuk u bë trameti. E ka kollaj të falë gjëra që nuk i ka, të falë diçka që e ka, selinë e ka sot, ta falë me që nuk ka asnjë funksion publik PD", - tha Veliaj. Qytetari i parë i Tiranës, u shpreh se për në shtator do të vendoset edhe projekti fitues për Teatrin, teksa shtoi se janë bërë dëgjesa të shumta publike, ku artistët që sot protestojnë, merrnin mesazhe nga koordinatorët të PD-së se di të bënin "zhurmë" kundër Teatrit të Ri. Kryebashkiaku tha se ata nuk janë aktorë, por recitues politik.

Ai theksoi se garancia për suksesin e dhe në këtë projekt të ri janë investimet e mëparshme sikurse sheshi "Skënderbej", pazari, liqeni etj, që pavarësisht skeptikëve, janë përqafuar tashmë nga të gjithë. Veliaj nënvizoi se referendumi edhe për këtë projekt ishte më 30 qershor, ku qytetarët votuan pro vijimit të punës nga Bashkia e Tiranës. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, foli në emisionin "Këndi i Ekspertit" për rolin e bashkisë për legalizimet në zonat informale, administratorët e pallateve etj.

PARKIMET

Qytetari i parë i Tiranës foli edhe për parkimet me pagesë në kryeqytet, ku tha se tashmë nuk ka më punonjës fizikë

për të dhënë lekët, pasi kishte vend për abuzime. "Ai nuk jepte faturë tani me celular, se kur ke makinë si mund të mos kesh lek në celular", tha Veliaj, duke shtuar se pagesa bëhet jo vetëm përmes celularit, por edhe në sajë të kioskeve që kanë vendosur ku mjafton të futësh monedhën për të marrë biletën.

LEGALIZIMET

Cili është roli i bashkisë për legalizimet në zonat informale? Procedurat që do të ndiqen. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, i ftuar në "Këndi i Ekspertit" në Report tv, me gazetaren Valbona Mhilli, sqaroi me detaje se kur roli i bashkisë bëhet vendimtarë në marrjen ose jo të

legalizimit të banesave informale. Veliaj tha se në momentin që Bashkia thotë se në një zonë të caktuar është projektuar zhvillim urban, atëherë shtëpitë kompensohen, por nuk legalizohen. "Legalizimi do të thotë që shtëpinë që ke bërë në vitet e tranzicionit t'i japësh dokumentacionin e një prone që ekziston por që është bërë pa leje e dokumente. Për këtë adresa është zyra e ALUIZN-it, që është bashkuar me Hipotekën. Në disa raste kur hyn mes për me një rrugë, aty hyn në lojë bashkia. Tek unaza e re nuk bën dot legalizimin, tek bulevardi i ri nuk bën dot legalizim. Por do të të kompensojë. Kur ke shtëpi, kompensohesh me kesh, ose me banesë sociale nëse do kokë më kokë. Kur është me tokë kompensohet me tokë", tha Veliaj. Sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë, Veliaj foli për përfitimet dhe shërbimet që merr qytetari nga pagesa e kësaj takse nga ndërtuesi. "Për një pronë që ka kaq metra katrorë që nuk ke paguar taksë ndërtimi, por ama një shumë e cila do shërbëjë që shtëpia jote të kalojë nga gropa septike dhe fekalet të shkojnë tek ujërat e zeza, me një kanal për të shman-gur shirat. Është caktuar nga qeveria e vjel ALUIZN-i, dhe është në të gjitha bashkitë", sqaroi qytetari i parë i Tiranës tek "Këndi i Ekspertit".

RRUGET

Veliaj zbulon se çfarë po ndodh nëntokë për herë të parë në Tiranë

Për herë të parë, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, zbuloi në Report Tv, se nga sheshi Skënderbej e deri në fund të Bulevardit të ri të kryeqytetit, janë ndërtuar galeri nëntokësore. Këto galeri, i japin fund një praktike të gabuar në Shqipëri, asaj të gërmimit të rrugëve dhe prishjes së tyre për rregullimin e defekteve që mund të krijoheshin me ujërat e zeza, etj. Kjo do të thotë, se të gjithë defektet do të riparohen nga nëngaleria, pa krijuar asnjë dëmim për rrugët e ndërtuara. "Bulevardi i ri do pësojë ndryshim. Nga fillimi i bulevardit do kalohet nën tokë, për të bërë të gjithë punimet. Në tokë do të ketë një galeri nga sheshi "Skënderbej" deri tek Lumi do të ketë një galeri, për të rregulluar defektet, çfarë janë shtylla e të gjitha duhet të jenë nën tokë, në sipërfaqe do të ketë vetëm gjelbërim", tha kryetari i bashkisë. Ka ndodhur shpesh që rrugë të rehabilituara të shkatërroheshin nga ndërhyrje të institucioneve të ndryshme, si për riparimin e rrjeteve elektrike, atyre të ujësjellësit, etj, që më shumë sesa rregullonin defektin e krijuar, dëmtonin rrugën duke e kthyer në makth për shoferët.



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurë për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, lënë garanci për "OTP Bank" sh.a

-NË DATË 15.08.2019 ORA 16:00.

"Ndertese" Pasuri nr. 54/49-ND, Vol.21, Fq.57, ZK.8605, me sip.20 m² me adrese lagja "28 Nentori", Vlore, ne pronesi te z.Et'hem Xhelaj dhe znj.Zilo Xhelaj, me çmimin fillestar 1,523,200 leke.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com



NJOFTIM

Shoqëria Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k., me adresë Blv "Gjergj Fishta" Pallatet "Gora Kulla 2, Kati 2, Apartamenti 9, Tiranë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, njofton se do të kryej procedurë për shitjen në ankand-2, të pasurive të paluajtshme në pronësi të shoqërisë "Alumix" sh.p.k me pale kreditore "Alpha Bank" sh.a

-Në datë 09.08.2019 ora 16:00.

"Apartament" Pasuri nr. 8/483+2-22, Vol.22, Fq.232, ZK.8120, me sip.112.7 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.22, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 42,560 Euro.
"Apartament" Pasuri nr. 8/483+1-11, Vol.22, Fq.179, ZK.8120, me sip.68.6 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Ap.11, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 26,600 Euro.
"Garazh" Pasuri nr. 8/483-G3, Vol.22, Fq.180, ZK.8120, me sip.160 m² me adrese Rr. "5 Maji", Korpusi B, Garazh nr.3, Tiranë, ne pronesi te shoqërisë "Alumix" sh.p.k, me çmimin fillestar 34,832 Euro.

Për informacione mund të kontaktoni nr Tel: 044500278 ose adresën e-mail: alsidkamberi@gmail.com entonmuhametaj@gmail.com

Ministrja Denaj: Kush abuzon 3 herë me kuponin tatimor, ndiqet penalisht

Bashkëpunim me Policinë e Shtetit, procedim për 30 zyrtarë të administratës

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, ka vijuar inspektimet si pjesë e zbatimit të Planit Operacional, në luftë kundër informalitetit. Gjatë verifikimeve të kryera nga strukturat e Hetimit Tatimor, në Tiranë, në orët me aktivitet më të lartë ekonomik është konstatuar se ka përmirësim të dukshëm të treguesve edhe për shkak të rritjes së ndërgjegjësimit të subjekteve për t'u vetëkorrigjuar. Megjithatë, nuk kanë munguar edhe raste të përsëritjes së vazhdueshme të shkeljeve. "Janë konstatuar shkelje për herë të tretë të kuponit tatimor dhe bazuar në procedurat tatimore, përgjegjësit në këtë rast do të ndiqen penalisht", tha ajo.

Nga ana e tij, zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, Ervin Hoxha, tha se gjatë kontrolleve të ushtruara janë konstatuar lokale me xhiro të lartë, që kanë shmangur detyrimin për të prerë kupon tatimor. "Kemi vënë re tendencë për mosdeklarim dhe mos përmirësim të xhiros nga këto subjekte, që janë me risk të lartë. Ju bëjmë thirrje që të vetëpërmirësohen dhe vetëdeklarohen sepse kontrollet do të vazhdojnë në mënyrë që të përmirësojmë këtë situatë", tha ai.

Gjithashtu, një aspekt i rëndësishëm në luftën kundër informalitetit është edhe ndryshimi i ligjit të Procedurave Tatimore, si pjesë e paketës "Moneyval", për të cilin ministrja Denaj kërkoi bashkëpunim e tatimpaguesve për zbatimin e plotë të tij. Ministrja e Financave dhe Ekonomisë u bëri apel tatimpaguesve të regjistruar të hapin llogari bankare të biznesit të tyre, jo më vonë se 90 ditë nga data 26.07.2019. Ndërsa, tatimpaguesit e regjistruar rishtas janë të detyruar të hapin llogarinë bankare të biznesit/organizatës, jo më vonë se 20 ditë kalendrike nga e nesërmja e regjistrimit në QKB/Administratën Tatimore dhe ta deklarojnë atë në organet tatimore.

AKSIONI

Gjatë javës 22-28 korrik janë kontrolluar 641 subjekte, ndërsa janë konstatuar 325 shkelje të legjislacionit tatimor. 28 subjekte janë konstatuar të paregjistruara në organet tatimore, për të cilët është marrë masa e bllokimit deri në momentin e regjistrimit të tyre pranë QKB dhe organeve tatimore. 24 tatimpagues janë kon-



statuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe 11 të tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune. 26 tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padëkluar, nga të cilët 23 subjekte janë të përgjegjësive tatimore "biznes i vogël" dhe 3 subjekte janë të përgjegjësive tatimore "biznes i madh". 71

tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë), ndërsa 3 tatimpagues u janë bllokuar ambientet për 30 ditë kalendrike për moslëshim kuponit tatimor (hera e dytë). 45 tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor. Përgjatë gjithë muajit korrik janë kryer 1.705

Aksioni

Gjatë javës 22-28 korrik janë kontrolluar 641 subjekte, ndërsa janë konstatuar 325 shkelje të legjislacionit tatimor. 28 subjekte janë konstatuar të paregjistruara në organet tatimore, për të cilët është marrë masa e bllokimit

kontrolle, ndërsa janë konstatuar 691 shkelje të legjislacionit tatimor.

POLICIA

Në përputhje me rolin e uniformave blu në mbrojtje të ligjit, edhe drejtori për Hetimin e Krimit Ekonomik e Financiar në Policinë e Shtetit Lutfi Minxhozi ka bërë bilancin e aksionit anti-informalitet që po zhvillohet prej disa javësh me theks të veçantë vijën bregdetare. Ai tha dje, në një konferencë shtypi, se janë proceduar 30 zyrtarë të administratës për shpërdorim detyre, mes tyre 5 të arrestuar, një zyrtar i bashkisë së Fierit, kryetari i njësisë administrative Dilaver Shyti me akuzën e favorizimit të evazionit fiskal dhe 4 inspektorë në Shkodër. Por ashtu si zyrtari i bashkisë së Fierit dhe 4 inspektorët në Shkodër gjykata i nxori nga qelia duke i lënë në masën e sigurisë detyrim paraqitje.

Minxhozi deklaroi se në shkallë

vendi janë ushtruar kontrolle në 801 subjekte të ndryshme, nga të cilët 467 shërbime vend-pushimesh me shezlong, 162 lokale në bregdet, 83 hotele, 24 ndërtime pa leje, 4 raste për territore të pushtuara dhe në pika shpërndarëse të karburantit.

Më shumë kontrolle janë kryer në Vlorë, po ashtu janë bërë më shumë ndjekje penale, për gjobat vendin e parë e mbanë Fieri, ndërsa për bllokimet kryeson Shkodra.

Si rezultat i këtyre kontrolleve janë evidentuar 89 subjekte në shkelje të ligjit dhe të gjithë përfaqësuesit e tyre janë proceduar penalisht për veprat penale: fshehja e të ardhurave, moslëshim i kuptonit tatimor, ushtrimi i aktivitetit tregtar i paligjshëm, mospagim i taksave dhe i tatimeve, ndërtim i paligjshëm etj.

Strukturat e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me ato të Tatimeve, Doganave, Inspektoratet Qendror Teknik etj., janë duke vazhduar me intensitet në shkallë vendi kryerjen e detyrave të përcaktuara në "Planin e Posaçëm të Masave, kundër informalitetit dhe evazionit fiskal në turizëm, ndërtim, hidrokarbure, tregtimin e mallrave të akcizës", deri në kontrollin e plotë të gjithë territorit të vendit.

Gjatë këtij operacioni masash, përveç parandalimit, evidentimit dhe ndëshkimit të subjekteve, vëmendja kryesore e strukturave të Policisë së Shtetit do të përqendrohet në zbulimin penal të çdo zyrtari bashkie, Tatimesh, IQT, Dogane, Punësimi etj., të cilët me dashje nuk kanë kryer detyrën për kontrollin e territorit, por kanë lejuar informalitetin, ndërtimet pa leje, ushtrimin e aktiviteteve të tregtisë së paligjshme, ushtrimin e aktivitetit tregtar pa kasë fiskale, shmangie doganore, në interes të tyre ose të personave të tretë, duke i sjellë dëme të konsiderueshme mjedisit, qytetarëve, bizneseve të ligjshme, nëpërmjet lejit të konkurrencës së pandershme si dhe kanë sjellë dëme të konsiderueshme Buxhetit të Shtetit.

Policia e Shtetit fton qytetarët të denoncojnë çdo rast paligjshmërie në numrin pa pagesë 112, në Komisarriatin Dixhital apo në adresat zyrtare në rrjetet sociale të Policisë së Shtetit, si dhe në numrin 0800 90 90 të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) në MB, duke garantuar anonimitetin dhe një reagim të shpejtë e të paanshëm, tha zyrtari i lartë i Policisë së Shtetit.

Statistikat TIRANE

Qershori ka sjellë një rritje të aktivitetit të transportit, në drejtim të lëvizjes si të mallrave ashtu dhe pasagjerëve, raporto i INSTAT në publikimin e fundit për Statistikat e Transportit. Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin qershor 2019 është 413 mijë ton, duke u rritur 48.9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në gjashtëmuajin e parë 2019, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.212.000 ton, duke u rritur me 13.9%, krahasuar me vitin 2018.

INSTAT: Rritet ndjeshëm aktiviteti i transportit të njerëzve e mallrave

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë në muajin qershor është 1.788.000 ton-kilometër, duke u rritur me 12.9%, krahasuar me qershorin 2018. Në gjashtëmuajin e parë 2019, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 9.650.000 ton kilometër, duke u rritur me 16.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në muajin qershor 2019,

volumi i mallrave të transportuar me ajër është 188 ton mallra, duke u rritur me 7.3%, në krahasim me qershor 2018. Në gjashtëmuajin e parë 2019, me ajër janë transportuar 1.145 ton mallra, duke u rritur 6.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë 2018.

Numri i fluturimeve të kryera, në qershor 2019 është 2.626, duke shënuar një rritje me 13.5%, ndaj qershorit 2018.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare, në qershor 2019 është 146.895, krahasuar me qershorin 2018, ky tregues është rritur 10.4%. Në gjashtëmuajin e parë 2019, kanë udhëtuar me linjë detare 482.822 pasagjerë, duke u rritur me 8.4%, krahasuar me një vit më parë.

Në muajin qershor 2019, transporti ajror i pasagjerëve zë 66.7% të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve



që kanë udhëtuar me linja ajrore, në gjashtëmuajin e parë 2019 është 1.411.479,

duke u rritur me 11.1%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndryshojnë rregullat për pasagjerët që vijnë nga jashtë vendit

Subjekti transportues detyrohet të japë informacion të hollësishëm për ta

GENC KONDI
TIRANE

Kompanitë e ndryshme të transportit ndërkombëtar ajror, detar dhe tokësor do të jenë të detyruara të japin një informacion shumë të hollësishëm të pasagjerëve të tyre, se këta të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me një projektligj të ri, që synon të bëjë disa shtesa dhe ndryshme në ligjin aktual nr.71/2016 "Për kontrollin kufitar", shteti shqiptar është duke marrë masa për vendosjen e një sistemi të informacionit paraprak të pasagjerëve, çka është edhe në përputhje me Direktivën e Këshillit të BE-së 2004/82/EC, datë 29 prill 2004.

DETYRIMI

Sipas projektit, të gjithë subjektet e transportit civil të udhëtarëve duhet t'i dërgojnë Policisë shqiptare Kufitare dhe të Migracionit informacion për pasagjerin që udhëton me mjetin e tyre, para se ai të mbërrijë në kufirin shqiptar. Kjo masë merret me qëllim parandalimin, zbulimin dhe luftën kundër migracionit të paligjshëm, terrorizmit, trafikimit e veprime të tjera të kundraligjshme, njëkohësisht me lehtësimin e qarkullimit të pasagjerëve.

Drafti thekson se termi "transportues" nënkupton çdo person fizik ose juridik, profesioni i të cilit është të sigurojë transportin e udhëtarëve nga ajri, deti dhe toka. Çdo transportues duhet të dërgojë informacion për të gjithë personat në bordin e avionit, tragetit apo autobusit, që ka të bëjë me: linjën ajrore të fluturimit; numrin e flu-

INFORMACIONI PARAPRAK PËR PASAGJERËT

Çdo transportues duhet të dërgojë informacion për secilin pasagjer para se të nisët si më poshtë:

Linja ajrore e fluturimit
Numri i fluturimit
Numri i dokumentit të udhëtimit
Lloji i dokumentit të udhëtimit
Shteti që ka prodhuar dokumentin
Shtetësia e pasagjerit
Emri i plotë i pasagjerit (emër mbiemër, sipas dokumentit të udhëtimit)
Datëlindja
Gjinia
Data e skadimit të dokumentit
Koha e nisjes së transportuesit
Koha e mbërritjes së transportuesit
Numri në total i pasagjerëve që transportohen
Numrin e bagazhit të pasagjeri (sipas çekinit për çdo pasagjer)
Pika e kalimit të kufirit për të hyrë në territor
Porti fillestar i imbarkimit
Vendi/porti i destinacionit të huaj

NDËSHKIMET

Transportuesi i pasagjerëve, i cili nuk transmeton të dhënat, ose transmeton të dhëna të paplota apo të rreme, do të jetë subjekt i sanksioneve, nga autoriteti përgjegjës për kontrollin kufitar, për çdo udhëtim, nga 500.000 lek deri në 1.000.000 lek për çdo pasagjer, në ato raste kur të dhënat e tij nuk janë transmetuar, ose të dhënat e transmetuara janë të paplota ose të rreme

Kur transportuesi shkel seriozisht detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji, me kërkesën e autoritetit përgjegjës për kontrollin kufitar, mund të vendoset pezullimi i përkohshëm ose heqja e licensës së operimit



Negociatat

Nëse Sistemi i Transmetimit të të Dhënave (programi) do të blihej, kostoja e programit do të jetë rreth 1.7 milion euro. Një opsion i dytë, që mund të jetë falas është në fazën e negociatave dhe ka të bëjë me bashkëpunim me SHBA



Informacioni

Pas hyrjes së pasagjerëve, brenda 24 orëve, policia kufitare duhet të fshijë informacionin paraprak për pasagjerët, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe nga ligjet për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë kombëtare


turimit; numrin e dokumentit të udhëtimit; llojin e dokumentit të udhëtimit; shtetin që ka prodhuar dokumentin; emrin e plotë të pasagjerit (emër mbiemër, sipas dokumentit të udhëtimit); datëlindjen; gjininë; datën e skadimit të dokumentit; kohën e nisjes së transportuesit; kohën e mbërritjes së transportuesit; numrin në total të pasagjerëve që transportohen; numrin e bagazhit të pasagjerit (sipas check-in-it për çdo pasagjer); pikën e kalimit të kufirit për të hyrë në territory; portin

fillestar të imbarkimit dhe vendin/porti i destinacionit të huaj.

Informacioni paraprak i pasagjerit (API) duhet të dërgohet menjëherë sapo Autoritetet Aeroportuale të kenë dhënë lejen e nisjes për mjetin. Ky informacion do të përpunohet nga autoritetet ligjzbatuese që operojnë në kufi.

SANKSIONE

Transportuesi i pasagjerëve, i cili nuk transmeton të dhënat, ose transmeton të dhëna të paplota apo të rreme, do të jetë subjekt i sanksioneve, nga autoriteti përgjegjës për kontrollin kufitar, për çdo udhëtim, nga 500.000 lek deri në 1.000.000 lek për çdo pasagjer, në ato raste kur të dhënat e tij nuk janë



transmetuar, ose të dhënat e transmetuara janë të paplota ose të rreme.

Ndërsa në rastet kur transportuesi shkel seriozisht detyrimet që rrjedhin nga dispozitat e këtij ligji, me kërkesën e autoritetit përgjegjës për kontrollin kufitar, mund të vendoset pezullimi i përkohshëm ose heqja e licensës së operimit.

KOSTOJA

Implementimi i sistemit API do të shoqërohet me efektet financiare në sigurimin e programeve të nevojshme për përdorim, në transmetimin dhe marrjen e të dhënave nga kompanitë e transportit të pasagjerëve si dhe në mirëmbajtjen e sistemit në vazhdimësi. Këto efekte financiare duhet që të planifikohen dhe të mbulohen nga buxheti i shtetit ose të sigurohen nëpërmjet donacioneve nga partnerët ndërkombëtar.

Sipas ministrisë së Brendshme, që ka hartuar projektligjin, ka dy rrugë të mundshme:

Nëse Sistemi i Transmetimit të të Dhënave (programi) do të blihej, kostoja e programit do të jetë rreth 1.7 milion euro; kostoja e instalimit do të jetë rreth 1.000 euro; kostoja e mirëmbajtjes do të jetë rreth 7-10% e kostonë së sistemit në vit dhe kostoja e shkëmbimit të të dhënave do të jetë rreth 2.000 Euro në muaj, por që mund të ndryshojë me rritjen e numrit të pasagjerëve.

Ndërkohë, ka edhe një opsion të dytë, që është ende në fazën e negociatave dhe ka të bëjë me një bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kështu, drafti parashikon që, nëse Sistemi i Transmetimit të të Dhënave do të sigurohet falas, siç po negociohet me Qeverinë e Sheteve të Bashkuara të Amerikës, (Department of Homeland Security), në kuadër të marrëveshjes për shkëmbimin e të dhënave të pasagjerëve: kostoja e programit, ajo e instalimit dhe ajo e mirëmbajtjes do të jenë zero. Por do të mbetet në fuqi vetëm kostoja e shkëmbimit të të dhënave, që parashikohet me shumën rreth 2.000 euro në muaj, gjithnjë në vartësi të numrit të pasagjerëve.

PRIVATËSIA

Pas hyrjes së pasagjerëve, brenda 24 orëve, policia kufitare duhet të fshijë informacionin paraprak për pasagjerët (API), përveç rasteve kur ato janë të nevojshme për autoritetet ligjzbatuese në funksion të përbushjes së përgjegjësi në kuadër të ruajtjes së rendit e sigurisë kombëtare, në përputhje me legjislacionin kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale.

FUQIA

Ligji parashikohet të hyjë në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

BIZNESI

Tatimet kujtojnë profesionistët e lirë: Duhet të regjistroheni!

Individët që nuk janë të punësuar, por ushtrojnë një profesion të lirë, pra kryejnë veprimtari ekonomike, kanë detyrimin të regjistrohen si subjekt tregtar, ka bërë të ditur Administrata tatimore. Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH", i ndryshuar, ushtruesit e profesioneve të lira, pavarësisht qarkullimit, duhet të regjistrohen

si tatimpagues i TVSH-së, edhe pse janë subjekt i regjimit të biznesit të vogël, vuri në dukje dje Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, pas kryerjes së regjistrimit, në vijimësi të veprimtarisë ekonomike duhet të respektojnë afatet e dorëzimit të listëpagesës, deklarates së TVSH-së dhe deklarates së tatimit në burim, nëse ushtrojnë aktivitet në një ambient të marrë me qira.

Në zbatim të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, çdo tatimpagues, përfshirë edhe personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ekonomike në një nga profesionet e lira, janë të detyruar të lëshojnë kuponin tatimor për çdo shitje të realizuar. Personat fizikë ushtrojnë veprimtari ekonomiko-tregtare vetëm pas regjistrimit të tyre, në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007

"Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal, regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Pra, individ i cili realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor, ka detyrimin tatimor për pagesën e taksave dhe tatimeve.



Hetimi për Llallën, akuza letërporosi në SHBA, përgjigjia mbërrin negative

ELTON QYNO
TIRANE

Prokuroria e Krimeve të Rënda, gjashtë muaj më parë i është drejtuar me një letër-porosi drejtësisë Amerikane, duke kërkuar ndihmën e kësaj të fundit, për çështjen penale që është duke hetuar, ku nën

Gjashtë muaj më parë prokuroria ka kërkuar të dhëna në SHBA për shpenzimet e gruas së Llallës

hetim është ish-kryeprokurori i Përgjithshëm Adriatik Llalla. Letërporosia është

ekzekutuar në muajin Janar 2019, duke i kërkuar drejtësisë amerikane të jepnin

një përgjigje për shpenzimet financiare që bashkëshortja e Adriatik Llallës, Ardiana,

ka pasur në SHBA, gjatë periudhës që ajo ka qëndruar në Amerikë, ku dhe ka lindur djalin e dytë të familjes Llalla.

kufi”, “Pastrimit të produkteve të veprës penale” dhe “Shpërdorimit të detyrës”.

PERSON “NON GRATA”

Ish-kryeprokurori Llalla prej muajsh ndan kohën e tij ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë, ku jeton edhe familja e tij pas një largimi të ngutshëm në mesin e vitit 2016. Në shkurt 2018, Adriatik Llalla, shpallen person “non grata” nga Departamenti i Shtetit Amerikan. Përveç Llallës, vendimi sanksionon hyrjen në Amerikë edhe për bashkëshorten e tij, Ardiana Llalla, të vajzës Eni Llalla dhe të një fëmije tjetër që nuk ka shtetësi amerikane. Ish-prokurori nuk është pajtuar me vendimin e marrë nga Departamenti amerikan i Shtetit dhe për ta përmbysur atë, ka punësuar në mars 2019 studio ligjore “Sher Tremonte” LLP. Studioja ligjore “Sher Tremonte” LLP nuk është një kompani klasike lobimi. Përveç Llallës, në formular listohet si financues i aktiviteteve të lobimit në një vlerë më të madhe se 5 mijë USD edhe një kompani nga Nju Xherisi, e quajtur “Lita Brothers Construction” – në pronësi të Bedri Lita.

LIBRAZH

Trajleri përplasat me automjetin, dy të plagosur

Një aksident rrugor është regjistruar mesditën e djeshme në qytetin e Librazhdit, si pasojë kanë mbetur të lënduar dy persona. Mësohet se në aksident është përfshirë një trajler i cili është përplasur me një automjet. Siç shihet nga fotot e siguruar nga gazetari i “Report Tv”, Aldo Kozarja,



automjeti ka marrë dëme të mëdha materiale, por fatmirësisht të plagosurit kanë marrë lëndime të lehta dhe ndodhen jashtë rrezikut për jetën.

NGJARJA

Bie rrufeja në kabinën elektrike në Kukës, fshati Surroj mbetet pa drita


Një kabinë elektrike është përfshirë nga flakët për shkak të motit të keq. Rrufeja ka goditur kabllo e tensionit të mesëm 10 kV e cila furnizon me energji elektrike fshatin Surroj. Flakët kanë djegur kabinën elektrike ndërkohë që tashmë pritet të dërgohet

një transformator nga Tirana për të furnizuar me energji elektrike banorët e këtij fshati. Moti në rajonin e Kukësit ka pësuar ndryshime përgjatë këtyre ditëve. Pas një muaji të shoqëruar me temperatura të larta, reshjet e shiut dhe erërat e forta.

DURRËS

I futi polakut pistoletën në makinë, gjykata mbyll në qeli agentin e SHISH

Graciano Hidri, një bashkëpunor i Shërbimit Informativ Shtetëror në Durrës është mbyllur në qeli, pas arrestimit nga policia e këtij qyteti për akuzën e “Mbajtjes pa leje të armëve”. Vendimi për mbylljen në qeli të Hidrit është marrë në datën ditën e shtunë nga gjykata e Durrësit. Zbulimi dhe arrestimi i Hidrit, i cili njihet në Durrës si bashkëpunor i SHISH, është bërë gjatë hetimeve që policia dhe prokuroria kanë ndjekur lidhur me arrestimin e një biznesmeni Polak, të quajtur Arkadiusz Modrzejewski, i cili kishte mbëritur në Durrës për çështje biznesi. Por tashmë teksa Hidri është mbyllur në qeli, shtetasi Polak Arkadiusz Modrzejewski, ka paraqitur kërkesën në gjykatën e Durrësit, duke kërkuar zëvendësimin e masës së sigurisë së “arrestit në burg”. Kjo pasi gjatë hetimeve është provuar se pistoletat tip TT e gjetur nga policia e Durrësit në makinën e polakut, ishte futur qëllimisht nga Graciano Hidri. Marja disa herë në pyetje i polakut tashmë të arrestuar për akuzën e “Mbajtjes pa leje të armëve”, ka sjellë nxjerjen e emrit të Graciano Hidrit, për të cilin polaku Arkadiusz, ngrinte dyshime të forta dhe akuzonte se pistoletat tip TT e gjetur nga policia e Durrësit në makinën e tij, ishte futur qëllimisht nga miku i tij në biznes, Graciano Hidri, i cili sipas polakut hieq si bashkëpunor i Shërbimit Informativ Shtetëror në Durrës. Pas verifikimeve të bëra nga policia ka rezultuar se Hidri ishte përfshirë në këtë ngjarje të rëndë, duke futur në makinën e mikut të tij Polak një pistoletë pa leje, dhe më pas ka njoftuar zyrtarë të SHISH në Durrës dhe këta fundit ja kanë përcjellë informacionin policisë, e cila më pas arrestoi poshtë banesës së tij, shtetasin polak Arkadiusz Modrzejewski. Gjatë hetimit është zbuluar se Graciano Hidri ka përdorin inspektorin e SHISH me inicialet A.S., të cilin e mbante në lidhje, me qëllim futjen në grackë të polakut tashmë të arrestuar, Arkadiusz Modrzejewski. Hidri është një njohës i mirë i gjuhës polake dhe ka disa kohë që është larguar nga ky shtet, ku dyshohet se ndiqet nga policia për akuzën e “Mashtërimit” në Poloni.



SHPLLJE ANLANDI

Shërbimi Përmbarrimor “Qeva shpk” shpall për shitje në ankand pasurinë e paluajtshme “Apartment” me sipërfaqe 100 m2, me nr. pasurie 5/68+1-4, vol.5, faq.159, e ndodhur në zonën kadastrale nr. 8582, Lagja nr. 5, Rruga Unazë, Përroi i Çaprazit Pogradec. Pasuria shpallet për shitje me Vlerë fillestare **4.965.000** (Katërmiljon e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Ankandi zhvillohet ditën e Hënë në datë 26 Gusht 2019

Personat e interesuar mund të paraqiten në adresën Lagja Nr.3, Rruga “Andon Xoxe”, Pogradec ose të kontaktojnë ; Cel:0672036006, E-mail: shoqeriaqeva@gmail.com

STRATI
BAILIFF SERVICE

Shoqëria përmbarrimore **“STRATI BAILIFF’S SERVICE” Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurisë së paluajtshme:

- “Arë”, me sipërfaqe 10565 m², ndodhur në Mbrostar-Ura, Fier, me Nr. 73/1 Pasurie, Zona Kadastrale 2636, volumi 5, faqe 18, rregjistruar në pronësi të Shoqërisë “**ABDURAMANI**” sh.p.k., lënë si garanci hipotekore për Tirana Bank sh.a., me kontratë hipoteke nr. 1131 Rep., Nr. 554 Kol., datë 03.05.2012. Çmimi fillestar i ankandit është **89.600** (tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind) Euro.

- “Arë”, me sipërfaqe 4900 m², ndodhur në Mbrostar-Ura, Fier, me Nr. 36/14 Pasurie, Zona Kadastrale 2636, volumi 12, faqe 126, rregjistruar në pronësi të Shoqërisë “**ABDURAMANI**” sh.p.k.. Çmimi fillestar i ankandit është **61.600** (gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind) Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 13.08.2019.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarrimore “Strati Bailiff’s Service”, Rruga “Jordan Misja”, Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Plot 16 vite pasi qëndroi pas hekurave Lulzim Caka, i njohur edhe si i Forti i Beratit ka lënë qelitë e burgut. Caka njihet si vrasësi gjakftohët ku për hakmarrje pas vrasjes së nënës së tij në vitin 1999 ai ekzekutoi Valter Begën dhe Mariglen Camin. Caka këtë krim e kreu duke u arratisur nga qelia e burgut ku qëndronte për të tjera vepra penale. Pas këtij krimi ai do të qëndronte në arrati dhe emri i tij do të rikthej në skenë teksa tentoi të vras zyrtarët e policisë Gani Malushin drejtorin e Beratit dhe Ilir Ngresin shefin e postët Kuçovë. Karriera kriminale e Cakës daton para vitit 1997 aty ku ai u përfshi në grupet kriminale të Kutallisë në Berat. Lul Caka i njohur edhe si i afër i Bujar Sulit, njohur si Loshi i Karbunarës një prej drejtuesve të bandave të Karbunarës dhe zonës Lushnjë-Berat arritën të krijonin grupin e tyre.

Pas 16 vite në burg, lirohet nga qelia Lul Caka

“I forti” i Beratit le ambjentet e burgut të Kosovës në Lushnjë. Nga grabitës në vrasës

GRABITËSIT E 97 QË U BËNË VRASËS

Ky grup operonte në aksin Berat-Fier dhe Berat-Lushnjë në grabitjen e udhëtarëve dhe pasagjerëve që përdornin këtë aks përgjatë vitit të mbrapsht 1997. Por ky grup u përfshi në përplasje me familje të fshatit Samiticë e Kutalli nga ku u shënuan viktimat e para mes tyre dhe Pëllumb Eminin. Në formë hakmarrje në 1999 u ekzekutua nëna e Cakës, për të



cilën ai më pas kreu dy vrasje. Në vitin 2003 Caka do të sillej në Shqipëri pas ekstradimit nga Italia, por nga ai momenti ai vuri në funksion planin për ti shpëtuar burgimit me 75 vite. Pas ekstradimit ai kërkoi rivendosje në afat dhe rishikim të dënimit, ku gjykata e lartë e më pas ajo kushtetuese i dhanë të drejtë duke rihapur procesin. Përfundimisht me një tjetër trupë gjyquese ai u dënua nga apeli i Vlorës me

25 vite burg dhe duke përlllogaritur paraburgimit 1 vit në 1.5 vite burg ai arriti të fitoj lirinë më 29 korrik 2019 në moshën 57 vjeçare.

PO KUSH ISHTE LULZIM CAKA?

Një i ri nga Berati që karrierën kriminale e nisi me vjedhje, grabitje, vrasje e plaçkitje mundi të kthehej në personazhin e botës së krimit. Kur ai ishte 33 vjeç u vu nën akuzë për vrasjet e para dhe deri në vitin 1996 kur ai u përfshi në atentatin ndaj Gani Malushit dhe Ilir Ngresit. Caka pas arratisjes në Itali ku qëndroi për një vit e gjysmë u prangos në Foxhia për tu sjellë në Shqipëri, ku ndërroi mbi 4 burgje deri sa u vendos në Kosovë të Lushnjes. Një vit para lirimimit për llogari të tij një sasi droge u tentua të futej në qelitë e këtij burgu e kamufluar brenda një sasi mishi, ndërsa pak muaj më pas Caka fitoi lirinë në moshën 57 vjeçare.

PJETËR PRELA DENONCOI VJEDHJEN E PRONAVE

Denoncoi skandalin e pronave Digjet për herë të dytë lokali tek “Rana e Hedhun”, pronari: Ja ku dyshoj, ata lidhën rojen

Një lokal është djegur mëngjesin e së dielës tek “Rana e Hedhun” në Shëngjin. Lokali që është shkrumbuar nga flakët është në pronësi të Pjetër Prelës. Ky i fundit është personi i cili denoncoi skandalin me tokat tek “Rana e Hedhun”. Report Tv” ka siguruar pamjet ekskluzive të momentit të djegies së lokalit gjatë natës, ku dëmet janë të mëdha pasi zjarri ka shkrumbuar çdo gjë. Po ashtu në një komunikatë telefonike për “Report Tv”, vetë Prela ka deklaruar se dyshon tek ata persona ndaj të cilëve ka denoncuar skandalin e pronave



REPORT TV EKS

tek “Rana e Hedhun”. Më pas Prela ka thënë se 5 personat që i kanë vënë flakën kanë lidhur rojën dhe më pas kanë tentuar t'i vënë flakën të gjithë kompleksit që ai ka në pronësi por nuk ja kanë arritur. Nga flakët

është djegur vetëm bari që është në plazh. Kjo është hera e dytë që lokali në fjalë digjet nga flakët. Edhe herën e parë flaka në lokal ka rënë gjatë orëve të vona të natës. Për rastin e parë roja i lokalit deklaronte se zjarri ka qenë aksidental për shkak të një defekti në ekspres. Ndërsa tani policia po heton në disa pista ku nuk përjashtohet ajo e konkurrencës por edhe për shkak të denoncimit që Prela ka bërë në lidhje me përvetësimin e pronave tek Rana e Hedhme nga zyrtarë lokal të Lezhës. Në lidhje me skandalin e pronave tek Rana e Hedhun

janë arrestuar disa zyrtarë të lartë bashkisë së Lezhës ndaj të cilëve gjyqet vijnë edhe sot. Zyrtarët lokal të hetuar nga Prokuroria akuzohen se në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë tjetërsuar afro 260 mijë m2 në zonën e plazhit, duke e kthyer në pronë private e më pas duke e shitur kundrejt vlerave të konsiderueshme monetare. Pronari i lokalit që është djegur gjatë natës tek “Rana e Hedhun” ka dhënë detaje të reja për ngjarjen në fjalë. Pjetër Prela ka deklaruar se zjarri ka qenë i qëllimshëm, ai dyshon se vjen si shkak i denoncimit të tij për skandalin e pronave. Sipas tij kanë qenë 5 persona të cilët kanë kryer këtë akt dhe madje kanë tentuar që të djegin edhe lokalet



e tjera. Në dëshminë e tij Prela ka thënë se personat që i kanë vënë zjarrin lokalit kanë lidhur fillimisht rojen në shtyllë. Më pas ka deklaruar se çështjen do t'ia lërë në dorë drejtësisë. “Nuk kemi pasur probleme familjare, kanë qenë punëtorët që janë zgjuar. Kam dhe disa lokale që kanë tentuar ti djegin

po janë zgjuar punëtorët. Kanë lidhur rojen për një shtyllë kanë qenë 5 persona. Agresorët kanë tentuar të djegin dhe lokalet e tjera. Dyshimet e mia janë tek ata persona që kam denoncuar për skandalin e pronave. Unë ketë çështje ia kam lënë drejtësisë”-ka deklaruar Prela.

NGJARJA NË VLORË

U ankorua në Karaburun nga moti i keq, shpërthen në flakë anija turistike, 5 persona hidhen në det

Një anije turistike e quajtur “Aquamarine” me 5 persona në bord ka shpërthyer në flakë në Karaburun. Anija turistike e linjës Karaburun-Sazan ka marrë flakë rreth orës 04:00 të mëngjesit të sotëm ndërsa shkak u mendohet të jetë një shkëndijë elektrike në motorin e anijes. Ndërsa të kontaktuar nga “Report Tv” shoqëria “Aquamarine” që ka në pronësi

anijen turistike që është djegur ka deklaruar se ishte e certifikuar ndërsa zjarri ka ardhur nga motori i saj. Së bashku me anijen janë djegur edhe një gomone 7 metra e gjatë si dhe një motor uji “Jet Ski”. Kjo anije arrin të mbajë në bord më shumë se 100 turistë, por në momentin e rënies së zjarrit kanë qenë vetëm 5 punonjësit e kësaj anije, pasi në të kundërt pasojat mund të ishin më të

mëdha. Ditën e djeshme nuk është dhënë leje për anijet që të dalin në det për shkak të motit. Deti i trazuar dhe dallgët e mëdha kanë bërë që anija “Aquamarine” të ankorohet në Karaburun që ditën e djeshme. Sapo kanë ndjerë zjarrin personat që kanë qenë në bordin e kësaj anije janë hedhur në det për të shpëtuar nga flakët. Ata kanë mundur të dalin me not në breg dhe

nuk raportohet të kenë marrë lëndime. Anija turistike ishte e përbërë me material druri, ndërsa shërbente si bar dhe si kuzhinë çka ka bërë që flakët të shpërndahen me shpejtësi në të gjithë trupin e saj. Kjo anije operon prej kohësh në brigjet e Vlorës dhe bën çdo ditë linjën shëtitëse të turistëve Karaburun- Ishulli i Sazanit. Flakët tashmë janë shuar plotësisht ndërsa nga



anija ka mbetur thajse asgjë. Ndërkohë policia ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të ngjarjes ku nuk përjashton

edhe mundësinë e zjarrvënies së qëllimshme për shkak të konkurrencës pasi anija ishte luksoze.

ELTON QYNO
TIRANE

Pesë persona që transportonin heroinën nga Maqedonia dhe më pas e fusnin në Shqipëri, duke e shpërndarë në grosistë të vegjël, janë marrë të pandehur nga prokuroria e Durrësit. Besmir Dashi, Amir Troci, Nexhmedin Uka, Alban Rajta dhe Xheraldo Dashi akuzohen për Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike të llojit "Cannabis sativa" dhe "Heroinë". Grupi i përbërë nga pesë persona që u arrestua në fund të muajit janar 2019 në Tiranë, në zonën pranë një qendre tregtare, është zbuluar nga një agjent i Policisë së Shtetit, i cili i është paraqitur trafikantit të drogës Besmir Dashi, se kërkonte të blinte prej tij një sasi të konsiderueshme heroine, me një vlerë prej 65 mijë euro. Agjenti i infiltruar kishte siguruar të dhëna se Dashi dhe bashkëshortja e tij arrinin të gjenin sasi të konsiderueshme heroine në Maqedoni dhe ta fusnin në Shqipëri, duke e përpunuar në një laborator në fshatin Paskuqan dhe më pas e shpërndanin në zona të ndryshme të Tiranës, Durrësit, Elbasanit etj. Gjithmonë sipas të dhënave të policisë së Durrësit çifti i bashkëshortëve hynte dhe dilte shpesh në Maqedoni vend nga e siguronin dhe drogën. Informacionet flisnin se 1 kg drogë çifti e shiste kundrejt 13 mijë eurove në qytete të ndryshme të Shqipërisë duke bashkëpunuar ngushtë me Nexhmedin Uka, Almir Troci dhe Alban Rajta dhe



Xheraldo Dashi. Në funksion të kryerjes së hetimeve aktive, ndjekjes në terren dhe përgjimit telefonik, prokurori i Durrësit Madrid Kullolli ka urdhëruar nëntor 2018 policinë që të kryejë veprime simuluese, duke infiltruar agjentë civilë me qëllim blerjen e sasive të vogla të drogës dhe identifikimin e plotë të këtij grupi kriminal. Kështu një agjent policie është vënë në shërbim të prokurorisë dhe

ka marrë disa herë kontakte me shtetasin Besmir Dashi, duke i kërkuar ti blerë sasinë e lëndës narkotike heroinë. Fillimisht në 16 nëntor 2018 në zonën e quajtur "Casa Italia", në një lokal aty afër Besmir Dashi i ka dhënë agjentit të policisë një sasi prej 1.5 gramë heroinë. Qëllimi i këtij takimi mes këtyre dy personave ka qënë pikërisht për marjen e kësaj mostre droge, ku synohej që të provohej cilësia e mallit dhe më pas të procedohej me blerjen e sasise më të madhe të heroinës. Pasi është marrë kjo mostër nga agjenti dhe është ekspertuar në laborator ka dalë se sasi prej 1.5 gramë drogë ishte heroinë. Më pas ai në datën 22 nëntor 2018 është autorizuar sërish për të kryer një blerje tjetër tek Bashkim Dashi. Tek i njëjti lokal në zonën e "Casa Italia" agjenti ka takuar Bashkim Dashit dhe ka blerë prej tij

534 gramë heroinë kundrejt një çmimi prej 7 mijë euro. Kjo ishte blerja e parë për sa i përket takimeve mes agjentit dhe trafikantit ndërkohë gjatë muajit dhjetor dhe janar agjenti i infiltruar dhe Besmir Dashi janë takuar vazhdimisht duke kryer biseda të shumta për sjelljen në Shqipëri të një sasive prej 5 kg lëndë narkotike heroinë. Në 30 janar 2019 të dy burrat janë takuar në zonën e TEG në Tiranë, dhe se nga hetimet e kryera rezultoi se shtetasi Nexhmi Uka së bashku me shtetasin Almir Troci kishin një sasi lëndë narkotike prej 5 kg, të cilën në ndërmjetësimin e shtetasin Besmir Dashi, kërkonin ta shisnin me shumën e rënë dakord me punonjës të policisë nën mbulim nën shumën prej 65 mijë euro. Por gjatë shkëmbimit të mallit me sasinë e eurove është bërë dhe ndërhyrja e policisë që mbante në mbikqyrje të



gjitha lëvizjet në distancë, duke sekuestruar sasinë prej 5 kg e 210 gramë heroinë të vendosur në 10 pako. Sipas prokurorisë i pandehuri Nexhmedin Uka ka kryer veprime konkrete në bashkëpunim me shitjes e heroinës, pasi ka pasur komunikime me Besmir Dashin dhe Amir trocin. Nga bisedat që ka Uka me personat e mësipërm dhe agjentin e policisë, del qartë se Nexhmedini, është personi që ka koordinuar lidhur me mënyrën e shkëmbimit të parave me lëndën narkotike dhe konkretisht duke orientuar lidhur me dorëzimin e mallit dhe mënyrën e marjes së parave. Madje Nexhmedini u ka pohuar agjentit se "...nëse gjithçka shkon mirë dhe nëse lënda ju pelqenë..., mund të sjellim sërish. Pasi ka marrë paratë ai ka shkuar në zyrë së bashku me tre persona ku ka numëruar lekët, plot 65 mijë euro, dhe më pas u ka kërkuar

personave që të dilnin pasi do pastronte zyrën. Por ata i kanë thënë që të prisnin dhe 5 minuta, ku gjatë kësaj periudhe kanë mbëritur forcat e policisë duke i arrestuar. Në cilësinë e provës materiale janë sekuestruar 5 aparate telefonike, 50.900 lekë të reja, 5815 euro dhe 1845 dollarë. Ndërkohë në pranga kanë rënë Besmir Dashi, Nexhmi Uka, dhe Amir Troci, të cilët në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me persona të tjerë kanë sjellë nga Maqedonia drejt Shqipërisë sasinë e drogës së lart përmendur. Nexhmedin Uka mësohet se është është pronari i një pike të këmbimit valutës "Geri 1997" dhe është arrestuar njëherë tjetër nga policia në vitin 2014, në vitin 2014 me 1.2 kg kokainë të sjellë nga Amerika Latine. Në atë periudhë Uka u arrestua së bashku me një ish-gardist të quajtur Alban Rajta.

GJYQI NË APEL

Dështon për herë të 3 seanca ndaj Klement Balilit, ja aryseja

Ka dështuar për të tretën herë seanca gjyqësore ndaj të ashtuquajturit "Eskobari i Ballknait", Klement Balili. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda shtyn për në 11 shtator seancën e radhës për të, ndërsa shkak për dështimin e seancës së tretë të Balilit është bërë mosparaqitja e Balilit dhe avokatit të tij, Theodhori Sollokau. Në këtë gjykim Balili kundërshton dënimin me 12 vjet burg të marrë në Shkallën e Parë të Krimeve. Klement Balili akuzohet për "Trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim, pjesëmarrje në grupin e strukturuar kriminal", "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive", si dhe për "Pastrim parash". Balili u vetëdorëzua mëngjesin e 15 janarit në policinë e Tiranës, pas 2 vitesh arra-



ti. Sipas prokurorisë, Balili dyshohet se ka qënë një nga financuesit, ndërsa autoritetet greke nxorren përfshirjen e tij

në trafikimin e një sasive prej 700 kilogramësh kanabis sativa nga Saranda drejt ishullit Zakynthos në Greqi.

Ngjarja në Tiranë




Tentoi t'i jepte para policit, arrestohet 40-vjeçari në "Don Bosko"

Policia Rrugore e Tiranës ka vënë në pranga një person i cili tentoi t'i jepte para efektivit të policisë në mënyrë që të shpëtonte nga gjoba. Ngjarja ka ndodhur në rrugën "Don Bosko" ku drejtuesi i mjetit të ndaluar me initiale A.B, 40 vjeç, gjatë kontrollit policor, me qëllim shmangien e testimit për alkool, i ka ofruar agjentit verifikues një shumë lekësh. Në këto kushte efektivët e Policisë Rrugore, kanë bërë arrestimin në flagrancë të drejtuesit të mjetit, për veprën penale: "Korrupsioni aktiv ndaj personave që ushtrojnë funksione publike". Gjatë javës që lamë pas, si rezultat i shtimit të kontrolleve janë evidencuar dhe goditur edhe dy raste të tjera të mitëdhënies.

AKSIDENTI

Makina merr përpara motoçikletën në Lezhë, drejtuesi i saj me urgjencë në spital



Një aksident ka ndodhur pasditen e djeshme në aksin rrugor Lezhë-Shëngjin në vendin e quajtur Sakë. Një mjet me drejtues B.T., ka përplasur një motoçikletë, drejtuesi i së cilës, T.D., 60 vjeç është plagosur dhe është dërguar në spitalin e Lezhës. Nuk dihen ende shkaqet e këtij aksidenti. Policia njofton se grupi hetimor vazhdon veprimet në vendngjarje për sqarimin e rrethanave të aksidentit.

Isuf Kalo: Kë takoi dhe çfarë tha Enveri para se të vdiste

Ish-mjeku personal i diktatorit Hoxha ka rrëfyer në emisionin "5 pyetje nga Babaramo" disa detaje e kuriozitete nga jeta e ish-udhëheqësve komunistë.



ILIR BABARAMO
TIRANE

Do të flasim për një libër që ka ngjallur shumë debate. Janë kujtimet e prof. Isuf Kalos, mjekut personal të Enver Hoxhës për gati 20 vite. I kam lexuar dhe kam një përshtypje të veçantë për këtë libër. Është një libër i shkruar me një frazë shumë elegante dhe me fakte që janë burimi i syrit të një klinicisti. Sa ka qenë subjektiv prof. Kalo në kujtimet e tij, të cilat janë rreth 500 faqe të botuara nga Shtëpia Botuese UET Press. Duhet pastaj edhe të analizohet dhe të reflektuar ta kuptoj në intervistën e sotme me dr. Kalon.

Libri titullohet "Blloku" – Rrëfimi i mjekut personal të Enver Hoxhës.

Kur keni filluar punë në Bllok?

E para desha të sqaroj se ky është një rrëfim, është memuar. Nuk kam pasur tendencë të shkruaj memuar apo të mbaj ditar. Është përjetimi i disa ngjarjeve, kujtimeve që janë kryesisht të përjetuara, por janë pastaj edhe të analizuar dhe të reflektuar me pas në vite.

Unë kam filluar punën si mjek në atë që quhej klinika e vogël apo klinika speciale apo klinika e udhëheqjes. Në fakt ka qenë një poliklinikë, pa shtetë në fillim. Fillova punë fill pasi mbarova Fakultetin e Mjekësisë, në vitin 1964. Por kam qenë mjek i përgjithshëm aty, kam punuar në spital 2-3 vitet e para, jam specializuar, por gjithmonë kam qenë kuadër i paguar nga klinika speciale. Nga viti 1971 deri në vitin 1973 më ngarkuar posaçërisht detyrën që të kujdesesha...

Që të hyje mjek në Bllok kishte shumë filtra, duhej të kaloje shumë filtra. Kush ju thirri, kush ju caktoi aty?

Filtri më i fortë ishte ai i biografisë. D.m.th. e para isha djalë i ri, isha mjek i ri. Unë kam një familje të lidhur, siç quhej atëherë, me luftën. Kisha dy vëllezër partizanë, disa komunistë, 6-7. Ne jemi familje e madhe. Ishim 8 fëmijë, 6 vëllezër dhe 2 motra. Them që është ajo dhe ndoshta karakteristikat e mira, për sjelljen, për mënyrën. Nuk e di se për çfarë kriteri, por filtrin e bënte, përveç Ministrisë së Shëndetësisë, nga e cila varej klinika speciale në atë kohë, e bënte padyshim edhe Drejtoria e Dytë e Ministrisë së Brendshme. Në qoftë se ti kishe lidhje, kishe njerëz të arratisur, ishte zor që të futeshe atje.

Profesor, do doja t'ju pyesja në cilësinë e mjekut personal të Enver Hoxhës, me një dëshmi të gjerë dhe të plotë që ka dhënë sekretari personal i tij Haxhi Kroj, të botuar disa vite më parë për një muaj rresht, në një të përditshme shqiptare, ku kjo gazetë boton ditarin e tij. Unë e kam lexuar të gjithë atë, të gjithë ditarin e Haxhi Kroit.

Edhe unë e kam lexuar.

Ok, aq më mirë atëherë. Dhe aty thuhet në mënyrë telegrafike, p.sh., "as sot shoku Enver nuk erdhi në zyrë". Por kjo nuk ndodhte me muaj me radhë, por ndodhte me sezone me radhë, me stinë me radhë dhe krejt papritur, pas shumë muajsh, Enver Hoxha shfaqej në zyrë vetëm, le të themi, gjysmë ore dhe largohet, gjithnjë sipas dëshmisë së Haxhi Kroit. Dhe kjo për vite e vite me radhë. Mua m'u krijua ideja d.m.th që nga viti 1973 deri në vitin 1985 ne na ka drejtuar një mit ose një fantazmë, një njeri i paaftë fizikisht për të punuar.

Cilësinë dhe performancën në drejtim të Enver Hoxhës nuk e vlerësoj dot as unë sepse duhen disa indikatorë për këtë. Por që fakti që Enver Hoxha nuk ishte fizikisht në zyrë ato ditë, nuk do të thotë që Enver Hoxha nuk ishte duke punuar në rolin që ai kishte. Enver Hoxha në shtëpi kishte një zyrë me bibliotekë,

me sekretariat, me të gjitha. Dhe për njërin nga këto arsye, nuk e quante relevante patjetër që të shkonte në udhëtim 100 metra më tutje, te zyra tjetër, për të bërë po të njëjtën gjë. Por është një gjë, që po të vini re, në asnjë event të rëndësishëm partiak apo shtetëror, kur duhej që të ishte Enver Hoxha, ai nuk ka munguar, përveç ditëve pas infarktit në vitin 1984 ose më pas kur u komplikua gjendja. Unë e kam thënë qartë, unë nuk kam qenë përditë me të dhe nuk e di se çfarë bënte ai në zyrën e tij, por Enver Hoxha shkruante. Ai ka shkruar. Të gjitha ato që ka botuar i ka me penën e tij. Sesa të rëndësishme janë është tjetër gjë, por Enver Hoxha varet se çfarë ndiente si detyrë për të bërë, një raport, një libër, direktiva, analizë, të lexonte libra që i vinin nga Parisi sepse i porosiste vetë. Por ishte i zënë, non stop i zënë.

A drejtonte fizikisht qeverinë Enveri?

Unë nuk e kam dyshuar ndonjëherë. Kam dhënë një dy shembuj në libër. Ta zëmë, një natë para se të vdiste, besoj, është koha më kritike, tek ai kishte ardhur Ramiz Alia dhe ndenji dy orë në dhomë me të. Kjo, në një kohë që ne kishim rekomanduar që atij të mos i çoheshin materiale pune. Ne mjekët, me aq autoritet sa kishim, por ne i bënim prezente rekomandimet që duhej të pushonte disa kohë. Dhe unë e pritja Ramiz Alinë poshtë, te dera kryesore në sallon dhe i thashë: "O Ramiz, ju kemi dërguar një material. A ka ndonjë mundësi që t'i ndërpresë shoku Enver kontaktet me çështjet e zyrës?". Ai tha: "Atë po mundohemi të bëjmë, me aq sa mundemi sepse ka disa gjëra, ju duhet t'i kuptoni, që duhet t'i shohë vetë dhe t'i firmosë sekretari i parë. Dhe sekretari i parë është Enver Hoxha, nuk jam unë". Këtë e tha një ditë përpara se ... Haxhi Kroj, meqë e përmendët, në ditarët e tij ka shkruar: "Sot i dërgova shokut Enver materialet e plenumit i cili duhej të bëhej në datën 10 prill", pra në ditën që ai ra në koma. Pra, materialet do t'i çoheshin në zyrë. Pse duhej t'ia çonte në qoftë se Enver Hoxha i kishte ndërprerë marrëdhëniet e punës? Pra, janë disa

argumente, pavarësisht rëndimit të gjendjes së tij fizike, ç'është e vërteta dhe minimizimit të përfshirjes së tij dhe kjo mund të ketë ndodhur nga viti 1984, pasi bëri një spazmë cerebrale. Ajo e rëndoi së tepërmi dhe krijoi imazhin e atij Enver që keni parë ju.

Pas vitit 1984 janë ato filmime? Për ato e keni fjalën?

Nuk e di ekzaktesisht, por natyrisht pas iskemisë cerebrale, unë e kam dhënë në libër me muaj e me data, ishte një gjendje që mezi u kalua. Bëhet fjalë për vitin e fundit. Megjithatë, ky episod tregon që ose komunikonte me anën e Nexhmijes me udhëheqësit, por nuk është shkëputur nga informimi sepse nuk guxonin dhe shokët e tij që ta ndërprisnin këtë gjë pa kërkesën e tij.

Duke pasur këto precedentë, duke pasur edhe kartelën mjekësore, gjendjen e tij, a menduat se duhej të sugjeroni që Enver Hoxha nuk duhej të punonte, duhej të reduktehej aktiviteti i tij politik.

Ne themi aktiviteti. Është politik apo është familjar apo është letrar apo është shkencor, kjo është punë tjetër. Aktiviteti në lidhje me atë mision dhe detyrë që ai ka ose me dëshirën që ai bën. Ne kemi dhënë rekomandimet tona dhe këtu ka qenë gjëja pak më e vështirë sepse Enveri nuk ishte pacient që të lejonte ta vije nën tutelë mjekësore. Ne mjekët kemi të bëjmë nganjëherë me pacientë që quhen pak si maniakë.

Para Zotit dhe para mjekut jemi të gjithë të barabartë.

Po, por ka pacientë të cilët duhet që ta masin tensionin 6 herë në ditë, që bëjnë analiza, që peshohen 4 herë në javë etj.

Pra maniakë

Quhen edhe kështu, por unë them këtë, që e teprojnë ose që për pak gjë, "më çpon këtu" apo "më ther këtu", bëjnë analiza. Janë ata që ne themi se kanë merak pas shëndetit.

“Momenti më i vështirë? Si desh na vdiq në duar djali i Enverit”

deri diku. Unë e kam adhuroar kur shkova sepse e quaja fat të madh atë që njerëzit e ëndërronin dhe nuk e kishin prekur asnjëherë, ndërsa unë e shikoja dhe e vizitoja e bisedoja me të. Pra të dyja bashkë ishin, karizma dhe hija e rëndë e frika që vinin nga autoriteti. Njerëzit autoritarë kur adhurohen... Unë asnjëherë nuk kam shkuar tek Enver Hoxha gjatë 12 viteve i shtendosur, në kuptimin që kam të bëj me një person sidokudo. Kam qenë shumë i vëmendshëm sesi të vishesha, si t'i afrohesha, si të sillhesha.

Keni pasur ose më saktë, cili ka qenë momenti juaj më i vështirë pranë tij, si mjek?

Momenti më i vështirë ka qenë kur u sëmur Sokoli nga apendiciti dhe u shty operacioni. E kam përshkruar edhe në libër. Mua ma kanë përmendur si gabimin tim, por ç'është e vërteta unë dyshova për diagnozën, e thirra kirurgun, por ai nuk u bind për diagnozën. Më pas zgjodhi një taktikë të gabuar, e shtyu me antibiotikë. Por erdhi një moment që ai u operua dhe kur u operua panë se apendiciti kishte plasur. Thanë që jeta e djalit nuk ishte e sigurt. Kjo ishte e tmerrshme që ta dëgjoje sepse ai ishte një djalë i ri, nmes të Tiranës, në mes të mjekëve. Ishte një gjë e paperceptueshme. Dhe pas operacionit, kjo gjë iu tha atij. Dhe ai nuk mund ta besonte këtë gjë. Atëherë më thirri dhe ishte si luan me krifë. Unë isha mësuar që ai të sillej shumë korrekt e ngrohtë me mua. Ndoshta sepse isha i ri në moshë, ndoshta sepse kishte besim. Dhe në atë moment unë nuk doja të isha. Ishte një moment shumë i vështirë. Ai vetëm pyeti disa herë pse dhe iku si furtunë. Unë isha si lepur. Ky ka qenë momenti më i keq. Një tjetër moment i ka ka qenë edhe kur unë, për herë të parë i regjistruam në Durrës në elektrokardiogram që kishte iskemi të zemrës, kurse deri atëherë i ishte thënë që zemrën e kishte mirë. Unë nuk dija se ç'mund të ndodhte gjatë natës sepse nuk kishim mjete që ta vinim në monitorim, për ta ndjekur në monitor. Nuk kishim mjete për ta defibriluar në qoftë se zemra do t'i ndalonte. Atë natë unë e kam mallkuar veten që isha bërë mjek sepse nuk e kisha menduar që mjekësia ishte aq e papërgatitur sa që edhe për Enver Hoxhën ne nuk i kishim mjetet dhe mënyrat e duhura. Pastaj erdhën disa shokë dhe ajo situatë u kalua, por sidoqoftë pritja e asaj nate ishte e tmerrshme. Ne ishim në Durrës në plazh, ku pati edhe një shtrëngatë me vetëtimë e bubullima, që mua më bëri supersticioz. Mendova që po bëhej kiameti.

Në subkoshiençën e tyre arrije që të lexoje një lloj brerjeje të ndërgjegjes, pse jo dhe frike për krimet që ishin kryer apo po kryheshin?

Përgjigjja është e thjeshtë. Jo, as mos i imagjinoni. Është shumë e sofistikuar kjo mënyrë që ata t'i brente ndërgjegjia kur kishin hyrë në atë valle. Problemi ishte që po të hyje në atë valle, ishe pjesë e saj. Dhe unë e kam trajtuar çështjen e nënshtrimit ndaj autoritetit, ose të nënshtrimit se kështu ishin rregullat, kështu ishin ligjet. Ti bëhesh pjesë e tyre dhe e humbet personalitetin dhe aftësinë për të reaguar, jo më pastaj për t'u qarë hallin të tjerëve dhe për të luftuar që të gesh të drejtën. Më duket shumë e sofistikuar në realitetin tonë dhe në realitetin e atëhershëm. Besoj se kjo është edhe sot.

Dakord, brerja e ndërgjegjes është një gjë e sofistikuar, por instinkti i vetëmbrojtjes, frika, është instinkt bazik, është instinkt jetësor. E kishin frikën apo e mendonin se ajo do të ishte një festë e përjetshme e tyre brenda në Bllok.

“Mehmet Shehu ishte i fiksuar pas shëndetit, e maste disa herë në ditë tensionin”

Kishte një diferencë midis atyre që quheshin kuadro të vjetra, të para, të cilët në trajektoren e jetës kishin reflektuar nga koha kur ishin adoleshentë dhe ishin partizanë 16-vjeçarë dhe pastaj u bënë gjyshër këtu dhe mësuan shumë çudira. Sepse kishte një gjë: nuk respektohej linja korrekte e karrierës. P.sh., në qoftë se duhej një ministër nuk zgjidhej një zëvendësministër për t'u bërë ministër. Madje nuk bëhej kurrë një zëvendësministër ministër. Nuk zgjidhej një drejtor i asaj drejtorie për t'u bërë ministër, por zgjidhej p.sh. një shef brigade në një rreth. Befas vinte ai dhe të gjithë këta që kishin bërë karrierë nga nëpunës i thjeshtë në ndihmës, në shef, në zëvendësministër prisnin. Vinte një njeri që nuk kishte asnjë dijeni. Pra kjo puna e ngritjes së kuadrit nga poshtë befaz lart, demoralizonte shumë nga këto kuadrot e vjetra, të cilët kishin shumë vite. Kishte sekretarë partie në rrethe që kishin 20 vite në një rreth, me bujqësinë, me blegtorinë, me vështirësitë që ka terreni. Befas anëtar byroje politike bëhej dikush tjetër që ishte dalluar në punë për një arsye apo për një tjetër. Kjo i demoralizonte. Pakënaqësitë që lindën në Bllok nuk është se lindën rastësisht te fëmijët e disave që unë kam përmendur.

Si e shfaqnin pakënaqësinë?

Pakënaqësia shfaqej me fjalë, me kritika ose me humor ose me tallje. Brenda tyre ata ironizonin edhe njëri-tjetrin. Ishte një qytezë ku gëlonin këto gjëra. Kjo ndodhte edhe në një qytet të vogël. Kjo ndodhte edhe me njerëzit e zakonshëm.

Në një intervistë që kam pasur me të ndjerën Liri Belishova, rreth 15 vite më parë, më ka rrëfyer që ishte lexuesi më i keq i mundshëm që ajo kishte parë. Gati e përshkruante si një sharlatan, që lexonte 5 faqet e para, 5 faqe diku nga mesi dhe 5 faqet e fundit. Këtë bibliotekë të bollshme e kishte thjesht si një hobi për të pasur një fond, një kapital aty apo ishte pasionant i vërtetë i të lexuarit.

Nuk është ky mendimi im. Enveri i donte librat. Titujt i porosiste vetë. Kur i vinin ndihje humori i tij. Vetë i nxirrte nga kutia dhe vetë i vendoste në bibliotekë. I dinte se ku i kishte. 2-3 herë kur ka rënë fjala për ndonjë libër, sidomos kur shkoja me Ylli Popën, ai ngrihej dhe na thoshte që ishte në filan sirtar. A i lexonte nga germa e parë deri tek e fundit, nuk e kam monitoruar. Por informacion kishte. Ndoshta bënte edhe lexim diagonal sepse varej sesa i interesonin disa gjëra. Por p.sh., për diabetin kishte lexuar. Kishte libra të një autori francez. Ai edhe mendonte në frëngjisht. Enveri jo vetëm fliste frëngjisht, por edhe mendonte. Nganjëherë më shpejt i vinte fjala frëngjisht. Për fat të mirë edhe unë dija frëngjisht, Ylli dinte. Në shkrimin e veprave të tij, me sa di unë, e kanë ndihmuar disa sekretarë që kishte në Komitetin Qendror. P.sh. Vait Lame ka thënë vetë që ka marrë pjesë në grumbullimin e informacionit për librin. Kur u sëmur shkruante me shumë vështirësi dhe e diktonte me diktofon. Mua nuk më kishte shkuar mendja, por dikush e kishte pikasur dhe më pyeti. Ishte

profesor Milezi në Francë. Natyrisht unë e anashkalova pyetjen dhe kur u ktheva e pyeta Nexhmijen, por ajo nuk reagoi. Por e vërteta është se ai i donte librat dhe e dinte vendin e tyre se ku i kishte.

Në librin tuaj, më ka bërë përshtypje mënyra proporcionale se si keni trajtuar personazhet kryesorë, nqs keni bërë një përshkrim interesant të Ramiz Alisë, të cilin unë modestish e kam njohur dhe është një portet që i afrohet tërësisht të vërtetës...andë nga jam unë përdorin një shprehje “sy për dhe” kështu ka qenë dhe ju kështu e keni vizatuar, mirëpo ai nuk kishte propagandën. Nuk kishte drejtuar institucione represive të diktaturës. Mengjyra krejt tjera, me afekcion keni përshkruar tre “satrapët, Hysni Kapon, Mehmet Shehun dhe Kadri Azbiun, pse ky shporpocion?

-Se di a është e saktë vlerësimi me afekcionin, kam folur për ta ashtu siç i njoha. Ua kam dhënë 40 vetave para se ta botoja, sepse natyrisht unë dua të jem i drejtë me të gjithë ata. Nëse e kam tepruar me diçka, kërkoj ndjesë, por arsyeja është se ai u bë i pari i vendit. Ai ishte përgjegjës dhe ngulmonte të krijonte njeriun e ri dhe mendoj që kjo ide është më e rëndë, se shkon nga brezi më rëndë. Të gjithë anëtarët e byros ishin më satrap, sepse nuk doli asnjëri që të japë dorëheqjen dhe të thonë nuk marrë pjesë në këtë kasaphanë. Ideja ishte se edhe pasi vdiqën këta “satrapët” u var një poet, ish-poeti i fundi në Europë, ai e kishte të pamundur të ishte më i mirë. Ai ishte një ish-Danov ndërsa të tjerët Beria... Unë nuk mund të bëj shkallën e fajësisë, ishte një grup me një ideologji të caktuar, unë në një kapitull i kam ndarë përgjegjësinë secili: Enveri qe shteti, qe lavdia; Mehmeti qe qeveria; Hysni Kapo qe partia; Ramiz Alia qe propaganda dhe ideologjia dhe ideologjia u vu në plan të parë, nuk u pa më bujqësia apo mbrojtja. U vu ideologjia mbi ekonominë, ajo udhëheqte.

Ju keni qenë afër dhe në mënyrë paradoksale me largimin e Enver Hoxhës influenca juaj duhet të jetë shtuar akoma më tepër, sepse shtoj misticizmi “mjeku i Enver Hoxhës”, një aerol...e bëra këtë parantezë që duhet të kishit një info të dorës së parë, përse hezitohet në rastin e marrjes së kredive, Çfarë diskutohej në bllok

-Pas vdekjes së Enverit, unë vendosa që t'i shpëpusë marrëdhëniet me bllokun dhe të shkoja në spital, aty ku kam pasur ëndërr edhe pse nuk më lanë. Ka qenë e kundërta. Kam mbajtur familjen Hoxha për inerci edhe pse Nexhmija ishte korrekte, por ajo u bë kryetare e Frontit dhe duhet të merrte shërbime mjekësore. Pse ka ndodhur nuk e di, por gjatë atij regjimi udhëhiqte ideologjia. Sekretari i parë nuk merrej me bujqësinë, por partinë.

Ju e shtruat në mënyrë retorike që “ai e kishte në dorë për ta ndryshuar, por pengohej nga Nexhmije Hoxha dhe fanatikët e tjerë”...

-Ky është mit! Nuk ka qenë ajo që udhëhiqte, njëshi është i padisikutueshëm, ajo që vjen pas njëshit është zeroja e parë, ky ishte sistemi i atëhershëm. Ai luante me atë që thoshte “nuk jam unë, por është ajo”. Ai kishte në dorë dhe të gjithë shpresonin, por e modeloi duke lënë rrënjët aty. Regjimet nuk hiqen se u kosit, por aty janë rrënjët...

Kam jetuar sa për të qenë i informuar se nuk kishte institucione, por vetëm me porosi dhe kam përshtypjen që realisht Nexhmija e drejtonte vendin...

-Kjo është një hamendësim, që thonin Nexhmija komandonte



Por ka edhe të tjerë, të cilët janë më racionalë, d.m.th. që bëjnë seleksione të çështjeve. Enveri nuk ishte maniak, në kuptimin që nuk donte mbikëqyrje mjekësore. P.sh. Mehmeti e maste shumë herë tensionin, bënte aktivitet fizik, vrapim, shkonte për gjah që të hiqte stresin, mbante dietë të fortë. Enveri, në kuptimin e diabetit që kishte, ishte një i sëmurë mjaft korrekt në lidhje me rolin që kishte, përveçse ndonjë shkelje të vogël të dietës. Në të vërtetë u fut në disiplinë. Ai e la cigaren, nga 60-80 cigare në o cigare, kur e kuptoi që kjo ishte e dëmshme për shëndetin. Por e kuptoi vetë. Mund t'i kishin thënë shumë vite më përpara që ta linte dhe ai nuk e la sepse ndoshta nuk e besonte. Kur u bind e la. La duhanin, ra në peshë, bënte lëvizje.

Në aspektin për gjithë popullin, për të gjithë publikun, d.m.th., Enver Hoxha për shkak të mitit që qe krijuar, kishte njerëz, gjysma e popullsisë, kishin lindur pasi ai kishte marrë pushtetin dhe i vetmi kontakt, i vetmi informacion që kishin ishte miti i tij dhe gjithçka rreth në funksion të idolatrisë ndaj tij. Ndërkohë kishte edhe njerëz d.m.th. që ishin në burg, ishin në Spaç, ishin në Burrel, kundërshtarë që ai i kishte përmbysur, familje të njerëzve që ai i kishte pushkatuar, të cilët e urrenin, por ndërkohë, pak e kanë njohur atë nga afër. Ju keni qenë më shumë se 20 vite afër tij.

Jo. Nga viti 1973 deri në vitin 1985.

D.m.th. 12 vite, mjaftueshmërisht për ta njohur. Ju e donit, e adhuronit atë apo e kishit frikë? Apo të dyja bashkë?

Po ta heqim politikën, ideologjinë, po t'i heqim çfarë kishte bërë sepse këto janë mënyra e sjelljes, sepse unë po flas për personin, si person, po ta kisha takuar te Qafa e Pazarit në Gjirokastër, një Enver Hoxhë të panjohur fare, Enver Hoxha ishte karizmatik. Ishte person shumë karizmatik, ishte elokuent kur fliste, ishte imponues, mbahej mirë, vishej mirë dhe kishte temperament, i cili bëhej herë gaztor dhe herë i vrenjtur, mundet edhe i frikshëm

Roli i Nexhmijes dhe Ramizit në vitet e fundit të jetë së Enver Hoxhës

← Enverin, por Nexhmija ishte e varur nga Enveri, i pas tij, e kishte idhull atë, më krijohet përshtypja se mos gabonte në ndonjë gjë...

Për aq kohë sa kontrollonte informacionin...

-Frika me respektin se nuk donte që t'i prishte qejfin, por kjo që thoni ju, nuk e di për Çfarë vendimarrje e keni fjalën. Nuk di të ketë në ndonjë proces të incizuar personalisht prej saj, të jetë firmosur apo të jetë nisur nga ajo.

Ju e keni vizatuar gati si një murgeshë të kuqe, që qe e obseduar nga feja e saj dhe i shenjtë i saj

-Besnike në ideologji, pa asnjë gjë origjinale nga ajo. Ajo haptazi ishte pozicionuar kështu, me telefonin është e vërtetë, por ishte e gjithë struktura dhe kjo bëhej për të mos lënë gjurmë. Jepej urdhër me celular, kjo nuk linte gjurmë diku, ky sistem i influencave krijoi sistemin e favoreve "po të kesh një mik, ke një Çiflig", por nuk ndodhte vetëm në Byro, por edhe tek drejtorët.

Ju përshkruani në libër sesi nga nr. 6 i regjimit, Ramiz Ala u bë nr.1, duke pastruar katër të tjerë...

-Nuk i pastroi Ramiz Alia, u pastruan...ky gabim nuk është i tij

Upasuan nga Enver Hoxha nën influencën e Nexhmijes?

-Hoxha pasi u sëmurë dhe erdhi nga vila nr.4, ka të ngjarë se ka pasur informacione se disa nga këta kanë lëvizur nga rreshti dhe mezi kanë pritur ose që nuk u gëzuan se ky u shërua dhe varianti i dytë ka filluar të mendojë për pasardhësin.

Babaramo: Në libër thoni që qe ishte qartazi Mehmet Shehu, por ndërkohë që krijuar se nr. 2 i regjimit ishte Hysni Kapo?

Nr. 2 qe Mehmeti, Hysniu qe i treti dhe e mbante me shumë mençuri distancën me Mehmetin. Ky i fundit i thoshte Hysni, ndërsa ai i thoshte "Shoku Mehmet". Unë kam parë që Hysniu me ndërgjegje dhe mençuri manovronte që të mos i linte Mehmetit idenë që ishin njësoj,apo që do dilte para tij, por kishte një gjë që ky rregull që Mehmeti qe i dyti, u vu në rrezik që kinezët kërkuar diçka që nuk u plotësua nga Mehmeti dhe Enveri. Ata kërkuar që këta të miqësoheshin me Titon dhe Cusheskin, Tito donte që të rehabilitohej Koçe Xoxa. Dhe kinezët e morën vesh që Enveri ishte sëmurë dhe edhe ata e kishin piketuar ata personat, Abdyl Këllezi (ekonomi) dhe Beqir Balluku (ushtri) që shkonin shumë shpejt në Kinë. Dhe u krijua përshtypja që kinezët po i afronin shumë, dhe i humburi në këtë rast ishte Mehmeti dhe për këtë arsye u spastrua ushtria dhe ekonomia.

Mehmeti ishte shumë i interesuar që nëse do i ndodhte gjë Enverit, ai donte që ta dinte i pari. Pse donte ta dinte? Keni momentin kur thotë "ky është numri im dhe mund të më merrni këtu..."

-Po, më tha mos njoftoni asken tjetër, se Nexhmija mund të hutohej...

Kapo e dëgjoi?

Hysni Kapo nuk e dëgjoi, se më mori veçantë. Nuk mendoj që Mehmeti kishte dyshime ndaj Hysni Kapos, se ai ishte besnik. Ndoshta Nexhmija donte të kishte qenë ai i pari se kishte afrimitet

Çfarë kujton Isuf Kalo, doktori personal i ish-diktatorit, për lidhjet e Sali Berishës me familjet bllokmene



Interesante, e ngjashme më një serial amerikan që përshkruan intrigat në Shtëpinë e Bardhë...

-Është çështja e pushtet, ku doka intriga të tilla. Njerëzit që janë atje, duan të dalin në kye. Kush mundet, bën aleanca. Nuk është e jashtëzakonshme.

Ju mbroni tezën që Shehu është eliminuar, por këmbëngulni tek versioni i vetëvrasjes, ndërkohë citoni ministrin që "kjo duket si vrasje se me dy plumba".

-"Kjo duket si...nuk është e tha...thuhet se tha"...A e tha vërtetë apo ia ngjiten, kjo është punë tjetër. Unë mendoj dhe i mbetem kësaj logjike, unë dalloj vrasje-vetëvrasje me eliminim se vrasje është diçka e rastit, ndërsa me eliminim është diçka e mirë-menduar për të të zhdukur hap pas hapi, me gjithë rrënjë. Mehmeti ishte në një situatë të tillë, e kam thënë në libër "nuk ka vetëvrasje" të gjitha kanë vrasje, por varet me çfarë me plumb, me helm, me fjalë...cili është mjeti për të të vrarë. "U vetëvra pasi e vranë" tha djali i tij... jashtëzakonisht e vërtetë. E vranë në sedër, merita, në krenari, në merita. Vrasja e tij nisi nga shtatori, u "vra" në mbledhjen e 17 dhjetorit kur iu sulën ata dhe kur u kthye në shtëpi, për fat të tij në atë mbledhje nuk u mor asnjë vendim, Mehmeti iku duke qenë akoma Kryeministër, komandat i lavdishëm....dilema e Mehmetit qe "donte më shumë jetë pa nam e lavdi apo nam e lavdi pa jetë?..."

Në 17 dhjetor ju çfarë keni parë tek Shehu?

-Jo nuk e parë, por e di që ka shkuar ka matur tensionin... kam parë gjyqin, mënyrën se si e shanin dhe ky mbrohej...ishte në tërheqje si ai boksieri në ring. Kur iku atë natë ishte ende kryeministër. Mehmeti politik ishte i vrarë... E vranë, nuk donte të ishte një "farë Mehmeti nga Mallakastra", por "shoku Mehmet", një hero dhe meqë i kishte këto poste të negocionte me Enverin, "çfarë do, do të më heqësh...ja po

iki vetë, po mi ruaj këto". Edhe unë do kisha bërë të njëjtën gjë.

Përveç Mehmetit që ju nuk e keni parë këto 24 orëshin fatal të jetës së tij, po Enver Hoxha, Kadri Hazbiu si kanë reaguar?

-Hoxha bënte moderatorin, Kadri Azbiu dhe Ramiz Alia ishte shumë agresiv, të tjerët nga Byroja ishin më të përmbytur. Unë kam dëgjuar mënyrën se si u konfliktuan dhe e poshtuan, si një gjel që ia hoqën pendët. Mehmeti u kthye me mendimin që ishte akoma kryeministër, nuk i tha askush Mehmet atë ditë, apo tradhëtar e armik (17 dhjetor) por "shoku Mehmet". Tani ky shoku Mehmet nesër në mëngjes nuk mund të bëhet armik...Ai llogariti "unë po iki vetë, ky le ta maskojë vrasjen të thotë "u shkreh arma"...

Gjithë kjo dilemë që merren me një fejesë...mund të bëhet analiza kaligrafike

-Po, kaq. Është e kotë që të zgjatet ky muhabet. Nuk i duhet të vrarë Mehmetit Enverit, se ai mund të kishte bërë aksident.

Pse?

Sepse vrasja krijonte ngjarje, nuk qe e tillë dhe trajtohej si vrasje. Ai donte eliminim shkallë-shkallë, që partia ia dha prap dorën Mehmetit, e çoi drejtor ferme, po cca do Mehmeti, ne ia dhamë dorë ai prap na sulmoi... Vetëvrasja e revoltoi shumë Enverin se nuk e priste, Mehmeti e vuri në një situatë Enverit ku duhet të zgjidhte se çfarë duhet të bënte.

Pse duhet ta mbante ende gjallë...kishte një mungesë kohe, nga 73-81 sa i hapi rrugën Ramiz Alisë, ishte në një garë me kohën dhe sëmundjen derisa të arrinte që avionin e Ramizit ta ulte në pistë?

-Unë mendoj që Enveri ka dashur që ta vendosë që në fillim Ramizin...kishte shpallur Mehmeti

Si shpjegohet që ne ishim vendi me diktaturën më të ashpër dhe pa një lloj desidence në tre dekadat e fundit? I vetmi që doli, lideri i opozitës ishte ai që donte të futej në grupin e mjekëve të diktatorit

-Pyetje për sociologët, unë them pati, por në mënyrë të fshehur. Krijimi i partisë social-demokrate nga Pjetër Arbnori, ka pasur pak përpjekje. Sekret i ishte për t'i parë gjërat ndryshe, prandaj jam Çuditur që edhe brenda bllokut ka pasur disidencë se ka pasur fëmijë të bllokut që përfunduan në burg...

Në libër ju përshkruani dhe krijimin e opozitës shqiptare dhe mikun tuaj zotin Berisha. Ka dashur të përfshihet në grupin e Hoxhës dhe është refuzuar për shkak të biografisë...

-Saliu nuk është se ka dashur apo është lutur. Unë doja që ai të ishte në ekip, ishte kardiolog i

ri, ka ndihmuar në mjekimin e Hysni Kapos. Në këtë kontest, Nexhmija thotë se ia ka propozuar Hysni Kapo, por dhe unë kam qenë dakord dhe kisha simpatinë, për këmbënguljen e tij për të çarë përpara, kisha parë fëmijë të bllokut të mbështetur nga prindërit që intelektualisht nuk ishin aq sa Berisha që vinte nga Tropoja.

Ajo fotoja e famshme në Drilon, rastësi apo miqësi e hershme...

-Ajo foto është abuzim. Në një event, mund të ketë qenë ditëlindja ime, nuk ka asnjë kontekst politik

Ju përshkruani në mënyrë interesante mitingun kur shpallet krijimi i Partisë Demokratike, kur projektohet lideri i ardhëm i Shqipërisë postkomuniste dhe ju ishit bashkë me dy kolegët tuaj, mjek dhe aty shfaqet miku juaj Berisha dhe ju thoni "ata u çuditën, unë jo".

-Ylli Popa u çudit, jo të dy. Unë në atë kohë isha shef i katedrës, me studentët dhe ata kërkonin atë që kërkuar në shesh. Prandaj, Ylli është një nga ata njerëzit që i kam pasur shumë pranë, i njohur për shkrimin "Në kërkim të kohës së humbur"

Ai shkrim është bërë me porosi?

-Nuk besoj, Ylli i ka pasur ato mendime Te Zëri i Popullit?

-Ai ka kërkuar që të mos ndryshohet, ai e vuri këtë kusht. Ndërsa dalja e Saliut nuk ishte surprizë. Ylli tha se kjo parti nuk do ishte e vetmja

Dy njerëz e promovuan, Ylli Popa si mjek dhe i doli nga kontrolli ndërsa si politikan Ramiz Alia që e njëjtë edhe për atë.

-Sepse e kam thënë se ai i besonte Zotit dhe energjive dhe forcave të tij, ishte këmbëngulës dhe energjik dhe isha i sigurt që do t'ia dilte kudo

Çfarë temperamenti kishte...imponues?

-Saliu e njohim të dy, unë e kam shok, iku e respektoj shumë cilësitë pozitive. Unë nuk jam në partinë e tij, as më ka ftuar as nuk kam dashur të hyjë. Ai mori politikën, unë mbeta gjithmonë në mjekësi. Në OBSH ika në vitin 1991, më kërkuar për një program European për diabetin, e fitova vendin me konkurs nuk kisha kontakte se kisha bërë një studim për përdorimin e pompave të insulinës dhe ne e mbaruan më me sukses dhe u bëri përshtypje që e kishim bërë me një fond minimal

Ju përshkruani krijimin e PS-së dhe thoni që ishte e kontrolluar nga Ramiz Alia

-Ai ka ndërhyrë, Ramiz Alia donte që të merrej partia e Punës dhe të ndryshohej.

Keni akoma kontakte me familjen Hoxha?

-Që kur ndodhën ndryshimet unë nuk jam më mjek e tyre, nuk më thirrën më, ndoshta ngaqë mbështeta studentët, ose ngaqë mbështeta Saliun. Ruaj kontaktet me Teutën, me Ilirin, por kanë mbetur vetëm kujtimet.

Paradë

FJALËKRYQESH



FJALËKRYQI PA SKEMË

DUHETTË NXINI **38** KUTI[illegible]

HORIZONTAL

1. Janë rrathë të shtypur.
-Tri shkronja për përsëritje.
-Gotat pa çifte.
2. Janë xhamllë.
-Fillojnë radhitjen.
-... novarum në një enciklikë të famshme
3. Nuk i shkelun parimorët
-Janë libra poetikë.
4. Fillojnë aplikimin.
-Lundër ne skaje.
-Kështu mund të jetë një
pagesë sa për të thënë.
5. Agjencia europiane i
hapësirës (sigla).
-Janë të dërguarit me veladon.
6. Robert De... i Taxi Driver.
-Dikur quhej Kanaan.
-Paul Anka.
7. Një pjesë e antologjisë.
-Munë të jetë vizite.
-Markë pistolete.
-Tipin por jo ti
8. Fillojnë një idil.
-Një lartësi në Lindjen e Mesme.
-Teke drite.
-Një është edhe baribal.
-Është zgjedhur në dhonë e lartë
-Ortolani kompozitor.
-Një mund të jetë karmelitan
10. Është brijnë në skuadër.

- Kanë simbol kërriçin të tillë në SHBA.
- 11. Kufijtë e lëvizjes.
- Eric Rochmer.
- Janë të drejtë më skuadër.
- Në fund të lutjes.
- 12. Është staff i shërbimit.
- Fillojnë ritmin.
- Fund shkurti

VERTIKAL

1. Tri të parat në evidence.
- Nin që qe shkrimtare
- Inicialet e Pasteur.
2. Atomike ajo e Salvador Dalí.
- Janë treguesë të tilla.
3. Është i treti kur janë... dy.
- Fillojnë nazet.
4. Një pjesë e praktikës.
- Të parat në sondaž.
- Bill i Microsoft.
5. Mund të jetë operacioni.
- Fernando... Angulo, piktor e skulptor kolumbian.
6. Një anestetik.
- Një është edhe Sebastian Vettel.
7. Gjysmë tatimi.
- Janë ata që kurohen me kininë.
8. Që edukator i Dionisit
- ... Greco që qe piktor.
9. Janë krahina.
- Dansi pa çifte.
10. Janë njëqindtë e dhëna në cililozim.

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT PA SKEMË

T	D	E	M	I	R	S	A	N	D	G	R	P
A	K	A	D	E	M	I	K	D	E	M	I	P
K	A	M	E	R	A	A	M	I	I	E	E	O
I	R	A	N	I	C	A	M	P	A	N	E	L
M	A	J	A	M	I	L	I	O	N	E	R	E
N	D	E	C	A	T	E	R	P	I	L	L	A
A	T	E	K	R	Y	E	V	E	P	R	A	O
M	I	L	O	S	A	O	I	A	U	E	N	A
A	N	H	A	I	R	T	E	N	A	R	A	L
N	A	T	A	G	M	A	R	S	H	E	T	L
E	A	R	I	N	A	N	A	E	T	O	I	L
T	A	R	A	N	T	I	N	O	D	R	A	M

- | | |
|---|---|
| <p>... Hot Chili Peppers.</p> <p>11. Makinë franceze.</p> <p>-Një stinë e akullt.</p> <p>12. Papa që shkroi Cuca e Maleve.</p> <p>-Kush është... është i aftë.</p> <p>13. Kështu mund të jetë një ide.</p> <p>14. Një vend si Katari.</p> | <p>-Anija e Nansen.</p> <p>15. Kalendat që nuk ekzistinin.</p> <p>-Khaçaturian kompozitor.</p> <p>16. Një veshje sportive.</p> <p>-Mbanin flamurin Jolly Roger.</p> <p>17. Thomas Mann.</p> <p>-Është edhe ai i skuadrës.</p> |
|---|---|

SUDOKU

PLOTËSONI VENDET BOSH NË MËNYRË QË ÇDO RRESHT E KOLONË TË KETË NUMRAT NGË 1 9

	1		2		8		9	
6	2			9			8	5
			6		5			
5		7	4	6	3	2		9
	3		9		1		6	
1		9	7	8	2	5		3
			3		6			
2	9			4			5	1
	7		5		9		2	

PËRGJIGJE

8	5	7	1	3	6	2	9	4
6	2	3	9	8	4	7	1	5
4	9	1	5	2	7	8	6	3
1	8	2	3	7	5	6	4	9
9	6	4	2	1	8	5	3	7
3	7	5	6	4	9	1	2	8
2	1	9	7	5	3	4	8	6
5	3	8	4	6	2	9	7	1
7	4	6	8	9	1	3	5	2

FJALËKRYOI **SPORTIV**

[illegible]

HORIZONTAL

2. Miralem mesfushor boshnjak.
6. Gjysmë armate
8. Seksion Sportiv Përmet
11. Janë në gotë
12. Enzo Bearzot
14. Skuadër italiane
17. Skuadra e plotë e Antonio Conte-s
18. Prost, ish-“profesori” i Formula 1

22. Fundi i Turandot
23. Janë të ndryshme në terezi
24. Qendër kurimi
25. Personazhi në foto
29. Makina Ibiza
30. Matet pa kufij
31. Lika trainer futbollit
32. Inicialet e Nolte
33. Një top në rrjetë
35. Një skuadër e Vjenës
36. Robben bomber

39. Gender

41. Mbyllin një takim.
42. Personazhi në foto
- VERTIKAL**
1. Një njëvëndëshe në Formula 1
3. Mario te Inter
4. Një sportiste si Federica Pellegrini
5. Skuadra azzurra
7. Është mënvërë për të

PËRGJIGJE E FJALËKRYQIT SPORTIV

	I	R	I		K	P		S	I	N	
	K	S	L	D	U	R	O	K	T	A	
E	R		O	T	A	U	R	R	A	A	S
	R		T	E	N	I	S	T	E	T	R
S	T	A	R	M	A	U	R	I	Z	I	O
I	D	A	V	I	D	S	I	L	V	A	E
R	D	A	K	O	L	A	M	O	G	I	
I	A	L	E	M			G	A	T	I	
A	D	R	I	E	N	C	A	N	T	O	N
	E	M	R	E	C	A	N	T	O	N	
						K	L	O	S	E	

- mësuar gjuhë
8. Tele që qe trainer brazilian
9. Ringo ish-Beatles
10. Një bomber te Verona
13. Një Real që luan në Benito
Villamarín
15. Fund tuneli
16. Kufizojnë ndikimin
19. Pak latinisht
20. Gjysmë aneksi
21. Janë në digë
26. Lëndë Helmuere Lutarake
27. Gjysme market
28. Lila mbrojtet
30. Sulmues krahu në Itali
33. Gjermania në tabela
34. Yoko e John Lennon
37. Në radhë te parë
38. Kush e thotë.... tregon
39. Nino Rota
40. Isaac Asimov

FJALEKËRYQI I KRIPTOGRAFUAR

10	3	2	6			16	8	4		14	6	2
5	8		4	6	10	3	9	1	10	8		3
9		2	1	7	6	11	3	7	8	11	3	
16	3	1	11		16	3	9	5	9		11	9
6	16	9	6	12		16	1	2	3		1	5
11	3	13			12		4	5	7	11	3	7
7		5	11	6	2		6	14	3		9	3
6	8	11	6	10	3			15		4	3	
7		6	4		2	8	14	1	9	3		9
	6		3	4	5		3	10	8	2	2	1
1	7		10	3	4	3	7	6		2	6	10
4	3	16	6	7		2	1		4	1	10	6

PËRGJIGJE

P	E	R	D	J	A		P	L	E	P	A	T
E	P	I		G	J	I	T	A	R	E	T	
	T	I	M	E		L		R	A	P		
R	L		D	E	M	I	U	R	G	U		P
O		E	G	E	R	S	I	R	A	T		
		G	A	N	I	M	E	I		N	O	P
K	U	K		S	O			B	E	L	A	
A		L	E	T	R	A	T		E	T		
	L	G	D	I		O	S					
A	J	R	I		A	L	B	A	T	R	O	S
J	A	K		B	L	A	I	R	E		E	I
A	E		G	A	I	C	A	N	T	E		

SHKRONJA E NJËJTË PËR NUMËR TË NJËJTË

Alba MALLTEZI **DREJTORE E PËRGJITHSHME E FREE AND FAIR MEDIA GROUP** ; Aurel PEPA **KRYEREDAKTOR**
 Patricia COSTANTINESCU **ADMINISTRATORE E PËRGJITHSHME**; Admirina PEÇI **KRYEREDAKTORE E "RILINDASI"** ;

LAYOUT DESIGN: Altin ALIAJ, **SHPËRNDARJA:** Spiro MESHINI **CEL:** +355696088847

Redaksia: Rruga "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë Tiranë. **Email:** shqiptaria.com@hotmail.com **Website:** www.shqiptaria.com **Mobile:** +355696060421 Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë

Departamenti i Marketingut: Patricia Costantinescu
Cel: +355696060419 - marketing@shqiptarja.com

NGA **EVIS CERGA**

Skema rrugore e fshatit Lin ka gjithnjë perspektivë nga liqeri, siç do ta "vuloste" i madh Lasgush. Lini njihet si rrjet rrugor antik, por edhe modern. Të gjitha ulicat shohin nga uji dhe nga qielli dhe në mes të fshatit gjendet kisha.

Në fakt, fshatin e sheh që kur rruga kryesore zë e dredhon për tu derdhur drejt qytetit të Po(g)radecit. Kuriozët e shohin me makina të parkuara, nga lart. Ndërsa marrim rrugën për tu futur në krahun që të çon drejt Linit, përpara na e pret udhën, hekurudha. Zbres dhe kërkoj një vend ku mund të bëj një fotografi. Rrallë mund të të bjerë mundësia nëpër Evropë të ndalosh në mes të shinave të trenit, pa pasur frikë se mos të ndalon njeri për terrorizëm, apo sëmundje mendore, dhe akoma më rrallë ndodh që nëpër shina të mos kalojë treni. Por kjo nuk është tema që më intereson. Zakonisht gjëra që nuk i di, apo për të cilat nuk kam zgjidhje individuale i anashkaloj.

Rrugës drejt fshatit njerëzit janë të vendosur ngjitur me muret, në këmbë. Ca duken sikur presin tu vijnë mysafirë, ca duken sikur presin turistë, ca thjeshtë duken. Fytyra të kohës së realizmit socialist. Me përpjekje për ta bërë fshatin e tyre turistik dhe këto përpjekje ndjehen nga do. Tre djem me biçikletë më thërrasin: O teta, kape, teta. E kanë fjalën për fotografinë. Ata nxitojnë mu përpara turinjeve të mi dhe unë nuk i kap dot. Por, pak më vonë, "kap" dy djem që hanë akullore.

Në hyrje të fshatit bien në sy "parulla" turistike "Welcome, sou-



venir shop", që u kanë zënë vendin atyre të tipit "Ta bëjmë fshatin si qytetin". Gati-gati më duket sikur e dëgjoj. Bën vapë ndaj edhe ulicat janë të zbrazura. Kjo më jep mundësi të rris "vigilencën" dhe ta kem fshatin "timin."

Përpara një porte, ballkonin e shtëpisë së të cilës e "rëndojnë" lulet e borës qëndron ulur një grua, me moshë të papërcaktuar, siç janë, në këndvështrimin tim, shumica e grave të fshatit.

- A mund të bëj një fotografi, - e

pyes dhe ajo pyetjen time e kupton si: "A mund të të bëj një fotografi? dhe më përgjigjet.

- Ja, të rregullohem pak.

- Atëherë, - i them, edhe nuses që ka nxjerrë kokën tek pragu i dyqanit që në kohën kur isha unë fëmijë do të ishte quajtur "Artikuj të përzjerë" (aq të përzjerë sa (nuk) të përzihej). Dalim bashkë në fotografi.

Dhe kështu shtohet edhe një fotografi mes njerëzve, të cilët më pas marrin "jetë" në skicat e tregimet e mia.

Shtëpitë e fshatit janë në orarin e pushimit. Kortinkat janë të mbyllura, oborret janë pastruar (ndonëse ky fshat nuk e ka pasur namin e pastërtisë, tani mendoj që ky nam është larguar). Shtëpitë janë të gjitha të ndërtuara me të njëjtin lloj guri, së paku për syrin tim.

Të gjitha shtëpitë "përfundojnë" në gjol. Bashtat e hapura, mbushur me mullaga, e bimë erëmirë. Poshtë një ballkoni më zë syri edhe aparatit e KESH-it që mat energjinë që harxhojnë konsumatorët. Vile rrushi varen

nga ballkonet. Dhe në fund të ulicës përballësh me të madhërismin gjol dhe varkat me ngjyra që qëndrojnë në pritje.

Përpara shtëpive tashmë gjen të pranishëm përpjekje të tjera turistike. Në gjuhë të huaj, anglisht, italisht dhe ndonjë gjuhë tjetër kupton që shtëpia jepet me qira. Madje edhe dhomat jepen me qira. Tek njëra prej tyre, gati-gati përballë kishës më del përpara një grua simpatike, me flokë kaçurrele.

- Come inside, please.

- Jam shqiptare, - i them.

- Eja brenda, eja shiko të lutem.

Dhe nuk e zgjat por më prin udhën drejt ulicës që të nxjerr në gjol. Një vazo e madhe me mullaga. Një gotatë e zbrazur që duhej të kishte pasur rrobat që ishin larë e pastaj ishin tharë. Në tela kishin mbetur vetëm kapsat, plastike, me ngjyra.

Tek "Shoqja nga fshati", Robert Ndrenika, në rolin e postierit të fshatit, kur i zuri vendin Malos dhe kërkonte martonte të bijën larg fshatit, ndërsa kjo e fundit nuk pranonte, ai thoshte: -Ah, kemi ecur shumë përpara. Unë tët ëmë vetëm natën e dasmës e takova, dhe nuk u ankova.

Edhe ne kemi ecur përpara, me plastikën...

Roza, ashtu e quajnë gruan me kaçurrele me nxjerr deri tek bregu i gjolit. Një tavolinë mbuluar me një centro të madhe, të punuar me grep.

- Ju bëj edhe drekë po të donimë thotë.

- Kësaj here, kemi studim tereni, - i them me të qeshur. - Ndoshta tjetër herë.

Të gjithë përpiqen të jetojnë në Lin. Dhe kjo ndjehet dhe në lëvizjet e fëmijëve që ndihmojnë gjyshtet në punët e shtëpisë, apo prindërit të shesin produkte të ndryshme.

Kisha e ka portën të mbyllur dhe kjo nuk habit njeri. Në fshat kështu ndodh. Ka kisha me porta gjithmonë të hapura, të tjera jo. Siç ka edhe shtëpi të vjetra, por ka edhe shtëpi, akoma më të vjetra.

Lini është një fshat që gjithsesi do vizituar. Qoftë, edhe për të vërtetuar që këto që kam shkruar janë të vërteta, por edhe për të "prekur" nga afër këta njerëz të fisëm, në një fshat të mençur të vendosur në rrëzë.

STUDIUESJA E PËRKTHYESJA

Rrëfimi i Ani Kokobobos për përkthimin e veprave të Kadaresë

Studiesja edhe përkthyesja Ani Kokobobo e rikthehet në Shqipëri pas një dekade. Kësaj here, e ftuar nga Qendra e Studimeve të Letërsisë Shqipe "Kadare" dhe Instituti "Pashko" Ani Kokobobo rrëfen për studuesit, shkrimtarët edhe përkthyesit shqiptarë kontaktin e saj të parë me letërsinë ruse, por edhe punën që ka bërë, si përkthyes e esreve të Ismail Kadaresë. "I kam lexuar veprat e Kadaresë në Amerikë, në gjuhën shqipe, sepse kanë qenë pjesë e studimeve të mia në universitet. Përkthimi i parë që kam bërë ka qenë "ikja e Shtërgut" për Lasgush Poradecin edhe për

fundin e tij, për këtë kam komunikuar me agjentët e Kadaresë", tregon Ani Kokobobo. Ajo ndalet edhe tek studimi i saj mbi veprat e Ismail Kadaresë, duke e parë se cilat janë dimensionet e figurave botërore, që shkrimtari shqiptar ka përdorur në veprat e tij. Sipas saj, "Dantja i pashmangshëm" "Eskili, ky humbës i madh" dhe "Hamleti, princ i vështirë" kanë bërë, që letërsia e tij të tejkalojë kufijtë. "Unë jam larguar në moshën 14-vjeçare nga Shqipëria, por gjuha e tij është shumë e pasur", tregon ndër të tjera studuesja.

Teksa e vlerëson penën e Kadaresë për gjuhën e pasur, ajo e

thekson se është krenari, që "Pallati i ëndrrave" është shkruar nga një shkrimtar shqiptar. "Për mua libri i preferuar është "Pallati i ëndrrave". Ai libër ka vlerë për të gjithë botën, për të gjitha fenomenet botërore, por shihja se si vendimet për zhdukjen e një njeriu mund të merreshin, si në një ëndërr, kjo më kthehet mua tek Shqipëria komuniste", thotë përkthyesja kokobobo. Ndonëse, vepra e Kadaresë për të është shumë e ndërlikuar, por është një vepër arti e vërtetë. Prandaj takimi i studieses me origjinë shqiptare me shkrimtarin Ismail Kadare në Tiranë ku diskutoi për literaturën



botërore edhe veprat e tij, ishte një emocion i madh. "Ishte shumë interesante që të diskutoja me të për literaturën edhe nga kjo pikëpamje ishte nder shumë i veçantë, që unë të ulesha edhe të diskutoja me një nga autorët më të mëdhenj të literaturës

botërore", shprehet ajo. Ani Kokobobo është larguar nga Shqipëria në moshën 14-vjeçare. Ndërsa, pas studimeve të larta punon si pedagogë e gjuhëve sllave edhe e letërsisë ruse në Universitetin e Kansas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.